

Studim projektim, për objektin
“Konsulencë për studimin dhe fizibilitetin e menaxhimit dhe
mirëmbajtjes se Sheshit Skënderbej”

PERMBAJTJA

1. Studimi i Pastrimit të sheshit skënderbej	7
1.1 Pastrimi I sipërfaqeve me pllakë	7
1.2 Pastrimi I sipërfaqeve me beton te lare dhe të rrashinuar	17
1.3 Pastrimi I sipërfaqeve me granil	21
1.4 Pastrimi I sipërfaqeve me asfalt	23
1.5 Shkarkimi I koshave të plehrave	25
1.6 Mirembajtje e vecante	25
1.7 Riparime ne raste demtimesh	26
2. Sistemi i Kanalizimeve	29
2.1 Pershkrim I pergjithshem I sistemit te kanalizimeve	29
2.2 Pastrimi I sistemit GATIC	32
2.3 Pastrimi I kanalit francez	32
2.4 Pastrimi I zgarave te shiut	32
3. Ndricimi	35
3.1 Llojet e ndricimit te perdorura ne Sheshin Skenderbej	36
3.2 Mirembajtja e ndricimit	56
3.3 Stafi mirembajtes i ndricimit	56
4. Mirembajtja e Gjelberimit	61
4.1 Grupi i punes	61
4.2 Seti i pajisjeve	62
4.3 Ndjekja dhe monitorimi	63
4.4 Pastrimi i barërave të këqija dhe Mbushje me ashkla pishe	64
4.5 Aplikimi i plehut dhe kimikateve	64
4.6 Kategorite e bimeve	65
4.7 Materialet	74
5. Mirembajtja e Shatervaneve	76
5.1 Pershkrimi i sistemit te pergjithshem	76
5.2 Shatervanet me presion	78
5.3 Pastrimi I shatervaneve me rrjedhje	78
5.4 Pastrimi I shatervaneve me presion	79
6. Çezmat publike	82
6.1 Pershkrimi i pergjithshem i çezmave publike	82
6.2 Pastrimi I çezmave publike	82
6.3 Mirembajtja	82
7. Puset e Furnizimit me uje per Shatervanet me Vaditje	85

7.1	Pershkrimi i pergjithshem i puseve te furnizimit me uje	85
7.2	Pastrimi i puseve te furnizimit me uje	85
7.3	Mirembajtja	85
8.	Kujdesi I dhomes teknike	87
8.1	Pershkrim I pergjithshem I dhomes teknike	87
8.2	Mirembajtja e dhomes Teknike: Stafi	104
8.3	Kujdesi I dhomes teknike: stafi mirembajtes	104
8.4	Mirembajtja e dhomes Teknike: hapesirat	106
9.	Mobilimi Urban	109
9.1	Veshtrim i pergjithshem mbi mobilimin Urban ne sheshin Skenderbej	109
9.2	Stolat (kontrukcionet e betonit)	109
9.3	Sinjalizimi dhe bordet e informacionit	112
9.4	Shatervani	112
9.5	Vendi i bicikletave	112
9.6	Koshat e plehrave (60liter)	113
9.7	Mirembajtja e karrigeve te levizshme	113
9.8	Mirembajtja e kangjellave	116
9.9	Lyerje te bllokuesve provizor te trafikut	118
9.10	Meremetime te Stolave te Betonit dhe te tavolinave te betonit	119
9.11	Riparime dhe lyerje te koshave te mbeturinave gjashte mujore	120
10.	Menaxhimi I eventeve	134
10.1	Pastrimi ne raste eventesh: per evente publike private	136
10.2	Rregullore per perdorimin e eventeve	137
10.3	Detyrimet e demtuesit	139
10.4	Kalendari I eventeve dhe njoftimi paraprak	139
11.	Kontrolli I transportit dhe qarkullimit	141
11.1	Percaktimi I automjeteve dhe mjeteve qe lejohen ne ambjentet e sheshit	141
11.2	Aksesi I pajisjeve dhe makinerive	144

1

MIREMBAJTJA E SIPERFAQEVE
TE SHTRUARA

1. STUDIMI I PASTRIMIT TË SHESHIT SKËNDERBEJ

Sheshi Skenderbej ka një varietet materialesh e shtrimesh në sipërfaqen e tij. Është e rëndësishme njohja me të gjitha këto lloje shtrimesh në mënyrë që të përcaktohet pikat e forta dhe të dobëta të këtyre materialeve. Duke njohur këto çilesi është me e thjeshtë zgjedhja e mirëmbajtjes së shtrimeve të hapësirave të sheshit Skenderbej.

1.1 Pastrimi I sipërfaqeve me pllakë

Ketu parashikohet të gjitha sipërfaqet e shtruara me pllakë guri duke përfshirë Sheshin Kryesor, sheshet përpara monumenteve të kulturës si Pallati I Kulturës, Muzeu Kombëtar etj bashkë me shkallaret e tyre si dhe xokolaturat e objekteve të cilat janë të shtruara me pllakë. Ky pastrim do të marrë parasysh 365 ditë të vitit dhe do të parashtrijë mënyrat e ndryshme të mirëmbajtjes duke bërë kategorizimin në baza të kohës që kërkon çdo metodë për tu kryer.

Pjesa më e madhe e sheshit është e shtruar me gur natyror të krahinave të ndryshme të cilat krijojnë varietet dhe e mbulojnë hapësirën qendrore të sheshit si një qilim ngjyrash të shumëllojshme. Gurët natyror të përzgjedhur për këto pjesë mund të jenë gure kompozite etj. Për përcaktimin e mënyrës së mirëmbajtjes së gureve natyrore është e rëndësishme të dihen dhe parametrat fiziko-kimike për të kuptuar reagimin ndaj lageshtisë apo efekteve të tjera të jashtme. Gurët natyrorë që janë përdorur për sheshin përmbushin disa kritere që lidhen me rezistencën, lageshtirën, absorbimin e ujit etj.

Sipërfaqja e kësaj hapësire është 26000 m².

- Pllakat në sheshin kryesor

Pllaka të permasave të mëdha të grupeve të gurit natyral me origjinë Shqiptare, janë të miksuara sipas skemës të specifikuar të vendosjes së pllakave. Produktet kërkojnë mjeshteri dhe precizion të madh gjatë zbatimit për arsye të mëposhtme: Permasat e mëdha të pllakave, terreni i pjerrët (gjeometria e ulët e piramidës), nevojat për korrespondencën të shatërvanëve të pllakave që i mbulojnë ato në sipërfaqe dhe furnizimi me ujë në sipërfaqe, ngjyra do të jetë ajo me baza në model.

Karakteristika e gurit:

Selektimi i gureve të ndryshme nga Shqipëria, të ndara në 4 grupe ngjyrash.

- Kerkesat teknike:
- Rezistenca: > 180MPa
- Perthithja e ujit < 3%
- Bllok i vazhduar dhe homogjen, pa defekte të dukshme në sipërfaqe
- Përfundimi: sharrimi

Shembuj grupi A (ngjyre e kuqe/boj kafe): Guri gelqeror Gjuras, Guri gelqeror Muhur



Guri gelqeror i Gjurasit



Guri gelqeror i Muhurit



Shembuj te grupit A

Shembuj grupi B (ngjyre blu/gri): Tipe te ndryshem Troctolite, konglomerat guresh, guri i erret i Korces



Gur traktoliti



Kongolomerat guresh



Guri i erret i Korces

Shembuj grupi C (ngjyre e gjelbert): Olivinit [Kalimash/Kukes dhe Tropoja](#)



Guri i Olivinit i Kalimashit



Guri i Olivinit i Tropojes

Shembuj grupi D (me ngjyre te bardhe): Guri i Korces



Guri i grupit D



Guri i Korces

Lista e gureve ne kete aplikim do te finalizohet ne komunikim me Ekipin e Projektimit, bazuar ne disponueshmerine e gureve ne guroret Shqiptare ne pajtueshmeri me kriteret teknike dhe kriteret e çmimeve.

Shtresat strukturale jane:

- Gur natyral
- Llaç çimento (perzierie rere me cemnto+lateks si aditiv), 40mm
- Hidroizolim me Mapei dhe me rrjete dy duar
- Nenshtresa betoni, 200mm
- Celik periodic D10mm cdo 20 cm ne dy drejtimet
- Nenshtrese stabilizanti kokra me e madhe 37mm, 150mm
- Nenshtrese zhavorri,kokraa me e madhe 75mm, 180mm
- Materjali i germuar per mbushje

Per specifikimet teknike te shtresave dhe te nenshtresave, i referohemi kapitullit IV. Model i rregullt ne nje shkalle te madhe me pllaka guri ne te njejtin raport me sheshin, dhe te njejtin orjentim.

Sheshi kryesor ka nje forme te ulet piramidale, me nje inklinim total prej 0.7%. Maja e piramides eshte e rrafshuar, duke ndjekur te njejten pjerresi. Pllakat jane projektuar sipas nje gjeometrie specifike , me pjerresi 1.96, 3.09, ose 3.38% ne krahet e piramides.

-Dimensioni i pllakes: 530*460*100mm perfshire dhe fugat

-Fugat: 6mm

-Fugat e temperatures: 10mm (model uniform/ nuk ka dallime ndermjet fugave)

1.1.1 Pastrimi ditor

Pastrimi gjeneral qe do ti behet sheshit eshte pastrimi I cili do te behet cdo dite. Ky pastrim nuk eshte I nje teknike te vecante por thjesht eshte nje pastrim me fshese nga punetoret e percaktuar I cili perfshin te gjitha hapesirat e sheshit Skenderbej dhe do te ndodhe nje here ne dite me qellim te heqjes se pjeses me te madhe te papastertive qe krijohen nga perdoruesit dhe kalimtarete e sheshit. Ky lloj pastrimi do te perfshije ambjentet e sheshit qendror dhe hyrjet e monumenteve. Punetoret do te pastrojne me fshesa standarte duke perdorur doreza plastike dhe duke mbajtur maska mbrojtese. Lloji I fsheses qe do te perdoret do te jete fshese me fije dhe me bisht alumini. Keta punetore do te jene te pajisur me karroca speciale per pastrimin e qytetit dhe me lopate plastike per grumbullimin e mbeturinave.



Pastrimi ditor me fshese

1.1.2 Pastrimi javor

Nje tjeter lloj pastrimi eshte edhe larja e ambjenteve te po te njejtave hapësira pra te ambjenteve te sheshit qendror dhe te hyrjes se monumenteve por ne nje menyre me intense me ane te larjes me uje me presion. Kjo menyre pastrimi do te behet me rralle se pastrimi me fshese duke mos qene nje menyre mirembajtjeje e perditshme , por javore , pra 52 here ne vit. Larja me uje me presion do te perfshije te gjitha hapësirat e shtruara me pllake.Edhe ne kete metode mirembajtjeje punetoret do te jene te pajisur dhe me maska mbrojtese. Kjo larje do te behet me uje me presion dhe do te kerkoje 2 litra uje per m2.



Pastrimi i pllakave me uje me presion

1.1.3 Pastrimi mujor

Pastrimi mujor do te jete nje pastrim I hollesishem me krah me spatula dhe do te kryhet per mbeturina te cilat do te jene me te veshtira per tu hequr si cemocakiza apo lloje te tjera mbetjesh.Te njejtat rregulla do te aplikohen dhe ketu persa I perket uniformave dhe karrocave qe duhet te pajisen punetoret.Do te behet kruajtja e pllakave ne te cilat do te kete mbeturina deri ne momentin e heqjes se ketyre mbetjeve.Do te perdoren spatula metalike te cilat do te jene nje perdorimshe.Me po te njejtën zgjatje kohore do te behet dhe pastrimi me fshese mekanike me rrotullim te cilat do te kalojne dhe do te pastrojne te gjitha keto siperfaqe te sheshit nje here ne muaj.Keto fshesa jane fshesa mekanike me koke pastrimi me perberje etileni dhe leshi te cilat pas cdo pastrimi do te zevendesohen.



Pamje e pastrimit me spatul

Ne foto tregohet menyra e pastrimit me spatul e cila do te jete e njejte per te gjitha siperfaqet te cilat kane nevojë per pastrimin mujor nga mbetje te cilat nuk mund te pastrohen me menytrat e tjera.



Pamje e fsheses mekanike me rrotullim


1.1.4 Pastrimi vjetor/ 6 mujor

Pastrimi I fugave te gureve natyrore

Fuga kontrolli per izolimi dhe bymim/tkurrje duhet te vendosen si tregohen tek plani "A-PA_01_pavement plan" ne nje rrjet prej 6x6m, dhe cdo ndryshimi ne forme (p.sh. kalimet e ngushta kur takohen me takime me te gjera); cdo ndryshimi ne drejtim (p.sh. rreth cepave); dhe cdo strukture rigjide qe mund te ndaloje levizjen dhe rrise rrezikun e krisjeve.



Pamje e fugave te gureve natyror



Dentimi i fugave te gureve natyror

Prerjet e sharres duhet te vendosen ne formacion per tharjen e te carjeve.

Keto fuga do te prihen me sharre ne beton. Te gjitha fugat duhet te jene te drejta dhe ne nje drejtim, sharrimi I gjurmes kur betoni eshte forcuar mjaftueshem per te parandaluar perhapjen, dhe perpara se te ndodhin krisje tkurrjeje. Ne princip, prerjet me sharre duhet te behen jo me shume se 12 ore pas trajtimit te soletes nese temperature kalon 25°C

dhe jo me shume se 16 deri 18 ore pas trajtimit te soletes per temperature me te ulta. Siperfaqja eshte e forte mjaftueshem kur nuk cifloset, thyhet ose shembet tek thika e prerjes (shqyerja).

Ne menyre qe te parandalohet shperngulja e grimcave aggregate te ekspozuara te palidhura ne fazat e meparshme, prerja do te ndodhe ne varesi te larjes finale te siperfaqes.

Gjurma duhet te mos shtremberohet dhe duhet te jete uniforme pergjate saj. Siperfaqja duhet te pastrohet teresisht pas prerjes per te hequr cimenton e ngjitur nga prerja me uje. Thellesia e fugave dhe hapsirat:



Fugat ne siperfaqet me beton



Thellesia e fugave


Fugat sharrohen ne nje thelesi prje 1/3 e thellesise se soletes per nje krisje te detyruar. Pranimi i krisjeve te rastesishme (p.sh. krisje tek vendodhjet e fugave te tjera) do te vleresohen ne sit dhe ne perputhje me standartet EN 1992-1-1:2004: krisjet inferior tek 0.4 mm nuk duhet te kene influence ne durueshmerine dhe te pranueshme vizualisht. Lidhesi I fuges

Fugat duhet te mbushen me nje set poliuretani te ftohte me performance te larte . Ngjyra eshte e zgjedhur nje nga nuancat e grise e propozuar nga mbikeqyresi. Ne menyre ideale, hermetizuesi duhet te blihet me tubete ne menyre qe te perdoret tek pistoleta izoluese. Kjo do te permiresoje performancen dhe jeten e fugave ne menyren e deshirua si ne vijim: Pergatitja e fugave: te gjitha faqet e fugave duhet te jene te pastra, te thara dhe me astar nese eshte e nevojshme. Aplikimi i izoluesve 'jeshil' betoni mund te rezultoje me fluska dhe te humbi ngjitjen ndermjet hermetizuesit dhe betonit. Temperatura e siperfaqes duhet te jete siper 5°C. Gjeometria e fugave: hermetizues te ndryshem kane zgjerim dhe kontraktim te ndryshem, trashesia e hermetizuesit ne fuge (dhe prandaj trashesia e fuges) duhet te jete e mjaftueshme per te pranuar levizjet e pritshme. Thellesia e hermetizuesit duhet te jete gjysma dhe kurre me e madhe se gjeresia. Thellesite me te medha te hermetizuesit reduktojne aftesine e materialit per tu zgjeruar apo kontraktuar. Ne rastin e fugave te diletacionit te cilat ndodhen cdo 9 pllaka (fug ate mbushura me silikon poliuritanik) kur digjen nga dielli duhet hequr silikonin I demtuar dhe rivene silikonin I ri.

1.1.5 Pastrimi I elementëve rrethues të pemeve

Ne sheshin qendror, eshte studiuar menyra me e mire e pastrimit jo vetem e elementeve horizontale qe shkelen, por edhe elementeve te ngritur te cilet jane vendosur per te bere nje kornizim estetik te baseneve te gjelberuar te pemeve ne sheshin qendror, por edhe per te mos lejuar kalimin e ujit ne menyre te pakontrolluar per ne kete basen te gjelberuar. Keto elemente jane gjithashtu te veshur me gure natyrore, ndaj eshte hulumtuar menyra me e mire per pastrimin e ketyre veshjeve. Eshte shqyrtuar menyra me e mire per ti pastruar ato, duke mos i demtuar dhe duke ruajtur sa me shume ngjyrimin dhe figurat e gureve natyrale.

Kjo menyre pastrimi behet duke u kryer larja me presion.



Elementet rrethues te pemeve



Elementet rrethues harkore te pemeve ne shesh

1.1.6 Pastrimi I shkalleve te monumenteve

Shkallet e sipërme te muzeut Kombetar (riparime te ekzistueseve) Konsiston ne riparimin dhe zgjatimin e pjeses se sipërme te shkalleve duke krijuar nje hyerje per ne Muzeun Nacional. Zgjedhja e gureve, po aq sa dhe dimensionet e tyre gjithashtu modeli i tyre do te perputhet dhe do te perzihet me pllakat ekzistuese. Kjo zone ka qene subjekt ndryshimesh ne shume vite. Nese te dhenat e sakta te materjalit ekzistues mungojne, pllakat e kolonave mund te sherbejne per perzgjedhjen e gurit dhe dimensionin e shtrimit te pllakave, vendosin lidhjet ne vazhdim me ekzistuesen. Trashesia e pllakave duhet te jete 50mm. E njejta pllake do te perdoret ne rampa e cila do ti japi



Plinta e muzeut



Pllaka e plintit te muzeut

Pjesa e sipërme e shkalleve të Pallatit të Kulturës (riparime të ekzistuesëve)

Kjo konsiston në riparimin dhe zgjatimin e pjesës së sipërme të shkalleve duke krijuar një hyrje për Pallatin e Kulturës. Zgjedhja e gurëve, gjithashtu dimensionet e pllakave dhe modeli i tyre do të përputhen me pllakat ekzistuese dhe do të perzihen me to



Pllakat e dyshemese dhe të kolonave , foto e 2016

Trashësia e pllakave duhet të jetë 50mm.

Shkallet e poshteme të Muzeut Kombëtar / Pallati i Kulturës:

Kjo konsiston në atë që shtrimi me pllaka të reja i pjesës së poshteme të shkalleve formon një hyrje në Muzeun Kombëtar, dhe Pallatit të Kulturës, konceptuar si një shkallë urbane me, materiale të cilat perzihen në hapësirat publike dhe në kopeshte.

Te dyja shkallet kanë një vazhdim të drejtperdrejte në shkallet e sipërme, dhe disa shkallë ekstra tek brinjët e sheshit kryesor, me një rrugë me beton të lare në mes, absorbon

pjeserisht hapat ne brinjet e tyre.

Karakteristikat e gurit:
Dragostun Shqiperi

Kerkesat teknike:
Rezistenca: > 180MPa
Thitja e ujit < 3%

Nje bllok i vazhduar dhe homogjen, pa defekte te dukshme ne siperfaqe.



Foto e gurit natyral te shkalleve

Shtresat e nenstruktures:
Gur natyral

Llaç çimento(perzjerje rere-cemento) 40mm
Nen shtrese betoni 200mm
Nen shtrese zhavorri 200mm

Per specifikime teknike te shtresave dhe te nenshtresave,i referohemi kapitullit IV.
Perberja e ketyre shtresave mund te ndryshohet ne menyre qe te kemi materjalin i cili mund te gjendet ne zone .Ne cdo rast, te gjitha ndryshime ne pershkrime duhet te aprovohen nga mbikeqyresi.

Modeli (ref. vizatimet: plani i dyshemese, detajet e modelit)
Skema e rregullt e bloqeve te gurit per shakllet, dhe pllakat e gurit per veshjet.

Dimensionet e bllokut te Muzeut Nacional: 600*420*150mm
Dimensionet e pllakave te Muzeut Nacional: 600*420*60mm

Dimensionet e bllokut te Pallatit te Kultures: 600*410*150mm
Dimensionet e pllakave te Pallatit te Kultures: 600*410*60mm

Fugat 3mm

Shkallet e monumenteve jane nje aset me shume perdorime. Keshtu, studimi mbi menyren

e perkujdesjes dhe mirembajtjes se tyre bazohet edhe ne menytrat e perdorimeve qe kane keto elemente. Veshja e shkalleve te monumenteve eshte bere me blloqe te medhenj guri natyral. Studimi i menyres se mirembajtjes se ketyre shkalleve te perbere nga blloqe te medhenj guri natyral fillon me njohjen e llojit te gurit natyral qe eshte perdorur per te ndertuar keto shkalle. Pas njohjes se llojit te gurit dhe karakteristikave te nise, studimi vijon me njohjen e dimensioneve te blloqeve te gurit natyral dhe menyres se si ato lidhen me njeri-tjetrin. Duke studiuar edhe menyren e perdorimit te ketyre shkalleve, niset procesi i hulumtimit per menyren me te mire te pastrimit, mirembajtjes dhe riparimit te tyre ne rastet e nevojshme. Hulumtimi per menyren e pastrimit e tyre mban parasysh qe materialet nuk duhet te humbasin ngjyren e tyre dhe figurat e tyre. Ne rastin e shkalleve te monumenteve, ndryshe nga rastet e tjera te perdorimit te gurit natyral eshte e rendesishme ruajtja e pamjes se gurit ne ato raste kur ato jane ne pershtatje apo ne perputhje me guret ekzistues te objektit. Pra, eshte e rendesishme qe cdo zevendesim apo riparim te jete ne harmoni me karakterin ekzistues te veshjeve te objektit dhe te respektoje ate nga pikepamja e ruajtjes se karakterit monumental te tij. Paralelisht do te studiohen projektet e meparshme te realizuara per kete projekt, per te evidentuar pikerisht metodet e pershtatshmerise se nderhyrjeve te reja qe jane bere ne lidhje me elementet ekzistues te objektit apo nderhyrjet restaurative qe jane bere per cdo rast. Menyra e mirembajtjes per keto elemente do te jete e njejtje me menyren e mirembajtjes dhe pastrimit te pjeses qendrore te sheshit me gur natyror.

1.2 Pastrimi I sipërfaqeve me beton te lare dhe të rrashinuar

Nje pjese e ketij projekti permban dhe nje pjese me beton te shpelare si ne rastin e struktures se rruges , trotuari I thjeshte I betonit ne kete rast. Eshte e rendesishme te dihet dhe perberja e ketij lloj material ne menyre qe te percaktohet menyra me e mire e mirembajtjes dhe e pastrimit. Ky material eshte I perbere nga ebene e zeze I disa llojeve , nga kuartzi Brazilian , rere uje, pigment te zi si dhe plastifikues. Eshte kryer njohja me perberjen konkrete te ketij materiali duke kuptuar ne kete menyre karakteristikat e materialeve te perdorura , kurbat e gradimit , perzierjet e betonit , konsistenca e betonit , forcat e kompesimit , ngjeshjes, densiteti etj.

Siperfaqja e vazhduar e betonit me perberesit ne dukje, eshte bere per te unifikuar 'hyrjen' e pedonale ne ane te ndryshme te sheshit. Materjali vesh siperfaqe pjeserisht te pedonale, pjeserisht i aksesueshem per ndaljen/ aksesin i zonave emergjente. Perberesit dhe gjithashtu masa e betonit jane ne ngjyre te erret. Nje rrjete ne shkalle te madhe eshte e vendosur ne zgjerimin e fugave sic eshte pershkruar dhe me poshte.

Mjeshteri e vecante kerkohet per perfundimin e siperfaqes ne te cilen ajo bashkohet me shkallet e Muzeut Nacional dhe Pallatit te kultures.

Siperfaqe me beton te rrashinuar dhe mozaik shtrihen ne 5450 m² , ndersa ato me beton te lare 7840 m².

Perberesit e Betonit arkitektonik (lista e plote e specifikimeve):

- Forca e betonit – rekomandohet 32 MPa.
- Rreshqitja – rekomandohet 100 mm.
- Agregati – tipi, ngjyra, forma, madhesia, tekstura, klasifikimi (rekomandohet hapsire mes klasifikimeve), proporcionet nese po perdoret me shume se nje aggregate.
- Vonues I caktuar – prodhues, norme aplikimi dhe procedure heqjeje.
- Tipi I fugave – shmanget prerja me sharre ne periudhe te hershme.
- Metoda e ekspozimit – e lare me uje.

- Thellesia e ekspozimit – 1/3 e madhësisë të agregatit
- Ngjytësi – ngjyra të puthitet me agregatin

Materialet:

Perberja e mëvonshme e betonit me ngjyre të zeze për shtresën e sipërme do të shërbejë si bazë, për hartimin e specifikimeve aktuale është përmendur më poshtë. Një përzierje alternative me rezultate të krahasueshme por e bazuar në materiale lokale do të jetë si më poshtë:

- Kompoziti referencë 1:
 - Noir Ebene 8/12 987 kg
 - Noir Ebene 1/3 100 kg
 - Noir Ebene 180 kg
 - Quartz Bresil 8/12 174 kg
 - Rere miks 0/2 364 kg
 - CEM III/A 42,5 N LA 400 kg
 - Ujë 200 l
 - Pigmenti i zi 25kg
 - plastifikues 4 l
- Betoni final duhet të duket sipas:
- Kompoziti referencë 2:
 - Porfier 14/20 330Kg
 - Porfier 6.3/14 570Kg
 - Kuarç I thyer I bardhë 5/8 180Kg
 - Bazalt 5/8 180Kg
 - Rere 0/2 550Kg
 - Cimento CEMIII/A 42.5 N LA 400Kg
 - Pigment (I zi) 16Kg
 - Plastifikues 0.5L
 - Agjente ngarkues ajri 0.4
 - Ujë 180L

Pikturë referencë e agregateve të betonit të ekspozuar



Betoni me ngjyre të zeze

Moster e betonit te zi te lare: cemento e zeze, aggregate te denduara, miks agregatesh te zeza mbizoteruese, hapsira-boshlliqet

Perzjerja e betonit do te jete si me poshte:

- karakteristikat e materialit te perdorur (rere, cemento, aggregate, pigment, llaqe)
- klasifikimi i kurbave te aggregateve, reres dhe perzjerjes
- perzjerja e betonit (ne pjesen masive beton per m³)
- konsistenca e betonit (renie nepermjet konit Abrams ose kohes VEBE), 30 minuta pas perzjerjes
- forca e ngjeshjes pas 7 dhe 28 diteve (cilindra □ 150 mm, h = 300)
- dendesia e thate e betonit
- tipi, kapaciteti dhe vendodhja e fabrikes se betonit
- rruga per te transportuar betonin

Vetite e aggregateve

- Ngjyra: mbizotruese e zeze (per tu percaktuar pas marreveshjes)
- Madhesia: kryesisht 3-10mm, vecanerisht jo me e madhe se 20mm.
- Perberja: Per te arritur nje dendesi me te madhe te aggregateve te medhenj tek siperfaqja, agregatet e madhesive te ndermjetme zakonisht harrohen ne perzjerje. Ne perzjerje perdoren nje perqindje e madhe e agregates te medhenj dhe nje perqendje te vogel e aggregate te vegjel.
- Forma: shmangni/limitoni numrin e copave pa formen e duhur (te sheshta e te zgjatura) te cilat reduktojne punueshmerine dhe mundet gjithashtu te kene nje efekt te kundert ne fortesine.
- Tekstura e siperfaqes.




Pamje e siperfaqeve me beton te rrashinuar

1.2.1 Pastrimi ditor

Ketu perفشihet pastrimi gjeneral dhe fshirja e komplet siperfaqeve me beton te rrashinuar dhe ato me mozaik si dhe me atom ne beton te lare ,e cila do te ndodhi cdo dite dhe te behet me ane te fshirjes si ne rastin e pllakava me gur natyral , me fshese me fije PE dhe konst alumini.Punetoret duhet te jene me doreza metalike dhe te kene karroca speciale per pastrimin e qytetit dhe lapate plastike me teh alumini.Do te kryhet pastrimi ne te gjitha kete siperfaqe duke grumbulluar te gjitha mbeturinat qe do te krijohen.

1.2.2 Pastrimi javor

Persa I perket pastrimit javor , si ne rastin e siperfaqeve me gur natyral ,edhe ne kete rast do te behet pastrim me uje me presion. Duke ndjekur te njejtat rregulla persa I perket punetoreve ,kjo lloj mirembatjeje do te behet duke I pajisur ata me veshjet e duhura , me doreza plastike dhe maska mbrojtese dhe me karrocet plastike te nevojshme.Me ane te ujit me presion do te behet pastrimi gjeneral I te gjitha hapesirave te cilat kane beton te rrashinuar dhe mozaik dhe me beton te lare.



Pamje e larjes se betonit te rrashinuar

1.2.3 Pastrimi mujor ne rastin e betonit te rrashinuar

Ne rastin e siperfaqeve me beton te rrashinuar dhe me mozaik do te kemi dhe pastrimin mujor , pra qe do te ndodhi 12 here ne vit dhe qe konsiston ne pastrimin me krah me spatula te cilat do te bejne kruajtjen dhe ferkimin e kesaj siperfaqe per te hequr mbeturina si cemcakiza etj , te cilat nuk mund te hiqen ne pastrimin me fshese apo me larjen me presion. Po te njejtat rregulla per punetoret aplikohen dhe ne rastin e ketij pastrimi.

1.3 Pastrimi I sipërfaqeve me granil

Zhavorri duhet te kete PH neutrale dhe inerte kimike sepse do te perdoret ne zonat e gjelberuara

Shtresa e siperme konsiston ne bluarjen e 8/16 (2-3 ton/m²). Ngjyra e zhavorrit eshte e zeze (bazalt ose gur i ngjashem lokal, nje bluarje e materjaleve te mbetura me gure te zi



eshte i mundur)

Pamje e granilit

Shembull i zhavorrit bazalt

Shtresat e nenstruktures

- Bluarja 80mm
- Geotextile
- Nenbaza e depertueshme e zhavorrit te bluar 150mm
- Nenshtrese zhavorri 250mm

Per specifikimet teknike te shtresave dhe nenshtresave, i referohemi kapitullit IV. Granili eshte nje tjetër material I cili shfaqet dhe perben nje pjese shume te rëndesishme te sheshit .Gjate pjese se studim projektimit eshte bere hulumtimi per menyren me te mire te pastrim te kesaj pjese duke studiuar karakteristikat dhe vetite e ketij materiali per zgjidhjen me te mire.

Siperfaqjet me granil zene nje hapësire prej 6630 m².

1.3.1 Pastrimi ditor (pa muajt e vjeshtes)

Pastrimi I ketyre ambienteve te sheshit behet ne trajten e nje pastrimi gjeneral , duke bere te mundur fshirjen e komplet siperfaqeve me granil.Keto siperfaqe marrin papastertira nga perdoruesit e kalimtare e sheshit por mund te grumbullojne papasterti edhe nga gjethet e pemeve sidomos gjate periudhes se vjeshtes por gjithashtu mund te ndodhi qe te kete dhe vegjetacion me kalimin e kohes.

Pastrimi ditor I ketyre siperfaqeve me granil do te behet nepermjet fshirjes se pergjithshme te ketyre hapësirave nga punetoret te cilet do te jene te pajisur me karroca speciale per pastrimin e qytetit .lapata plastike me teh alumini ,fshese me fije PE dhe



Pastrimi ditor i siperfaqeve me granil

konstrukcion alumini si dhe maske mbrojtese. Ky pastrim do te behet me fshese te thjesht duke kaluar neper te gjitha keto hapsira. Pjeset e cilat do te kene vegjetacion do te pastrohen dhe ne po te njejten menyre do te hiqen dhe papastertite.

1.3.2 Sistemime ditore



Kreher metalik per sistemim ditor te granilit



Kreher metalik per pastrim sezonal gjethesh


Duke patur parasysh qe keto hapësira perdoren si pjese qendrimi , kalimi mund te ndodhe qe te duhet sistemimi I cili ben nivelimin e siperfaqeve me granil si dhe mbushjen me material ne rastin qe lind nevoje e kthimit te kuotes fillestare te kesaj hapësire e cila eshte e njejten me kuoten e hapësirave perreth. Ky sistemim behem me ane te nje kreheri metalik.

1.3.3 Pastrim sezonal

Ky eshte nje pastrim I cili do te kryhet gjate stines se vjeshtes per shkak te renies se gjethëve ne kete siperfaqe te shtruar me granil. Do te behet mbledhja e gjethëve per tre muajt e ketij sezoni me ane te nje kreheri metalik, ne menyre delikate , pa prishur nivelimin dhe pa ndryshuar kuotat e kesaj siperfaqeje.

1.4 Pastrimi I sipërfaqeve me asfalt

Hulumtimi i pastrimit te asfaltit ka qene nje proces teper i kujdesshem, pasi ne studim-projektimin synonte te kerkonte menyren me te mire per te pastruar pjesezat e ndryshme te asfaltit jo vetem si nje qilim te tere, por edhe guret dekorative qe ka ne perberje. Menyra e studimit te pastrimit eshte bere ne menyre te tille qe te mos demtohet apo preket pamja estetike e tij. Eshte shqyrtuar se cila eshte menyra me e mire e pastrimit te gureve dekorative duke ruajtur pamjen e tyre. Paralelisht jane shqyrtuar edhe projektet dhe studimet e meparshme te bera ne lidhje me asfaltin, dhe nenshtresat e tij. Jane shqyrtuar parametrat e tij teknike, dhe rezistenca e tij si material shtrimi. Eshte hulumtuar mbi menyren me te mire per tu kujdesur per te duke mos dobesuar parametrat teknik te



Pamje e sipërfaqeve të shtruara me asfalt

tij dhe ruajtur qendrushmerine e tij. Hulumtimi do te fokusohet ne tipologjine e asfaltit, ne ate qe eshte parashikuar per te perballuar trafik makinash, dhe ne ate qe eshte parashikuar vetem per kembesoret. Keshtu menyra me e mire e pastrimit dhe zevendesimit te tij kur eshte e nevojshme do te behet per secilin rast respektivisht.

Ky material ze nje hapësire prej 10100 m².

1.4.1 Pastrimi ditor

Pastrimi ditor qe do ti behet ketyre siperfaqeve te afaltuara do te behet per 365 dite te vitit ,nje here ne dite per te grumbulluar dhe hequr pjesen me te madhe te mbetjeve qe shkaktohen cdo dite.Kjo teknike pastrimi do te behet nepermejet punetoreve te cilet do te jene te pajisur me dorezat e pershtatshme dhe me maska mbrojtese,me karroca special per pastrimin e qytetit dhe me lapata plastike me teh alumini.Te gjitha papastertite e krijuara do te mblidhen me nje fshese me fije PE dhe konstruksion alumini.

1.4.2 Larje 180 dite te vitit

Menyra tjeter e mirembajtjes se ketyre siperfaqeve nuk eshte e perditshme si ne pastrimin me fshese. Ky pastrim do te kryhet me larje me uje me presion dhe do te ndodhi ne 180 dite te vitit, duke marre parasysh me se shumti ditet e thate te vitit dhe ato me pak te lageshta. Rregullat per mjetet me te cilat duhet te pajisen punetoret duhet te jene te njejta dhe te aplikohen ne po te njejten menyre si ne metodat e tjera te pastrimit.

1.5 Shkarkimi I koshave të plehrave

Shkarkimi I koshave te mbeturinave do te behet nga punetoret per cdo dite te vitit , pra per perkatesisht 365 dite, dy here ne dite.
Ndërrimi I qeseve plastike ekologjike

Pjese e procesit te mesiperme do te jete dhe nderrimi I qeseve plastike ekologjike I cili eshte process shoqerues I shkarkimit te koshave te plehrave dhe do te kryhet cdo dite , per cdo here qe behet pastrimi I koshave.

1.6 Mirembajtje e vecante

Disa prej mbeturinave qe mund te demtojne materialet prej te cilave perbehet sheshi Skenderbej nuk jane lehtesisht te pastrueshme nepermjet metodave te pastrimit te mesiperme.Ne rastin e renies se bojës apo vajrave te ndryshme duhet parashikuar nje menyre efektive mirembajtjeje.

Ne raste te tilla te cilat do ti specifikojme si raste te vecanta mirembajtjeje do te behet pastrimi me ane te perdorimit te materialeve te tjera.

Ne rastin e derdhjes se vajrave te makines , I cili mund te jete vaj hidraulik ose vaj motorri hapi I pare qe duhet marre eshte te mbulohet kjo siperfaqe me rere te imet ne menyre qe te absorboje pjesen me te madhe te vajit.

Pas ketij procesi dhe pas mbledhjes se reres behet larja me variante te benzines dhe duke u ferkuar me leckë me pas dhe duke u shplare me uje me presion.

Gjate punimeve te ndryshme mund te ndodhe qe te kete incidente dhe me boje mbi keto

siperfaqe. Ne rastin kur kjo boje thahet , pastrimi nuk eshte me I njejte por duhet perdorur spatula per krruajtjen dhe ferkimin e pllakave deri ne heqjen e bojës. Kjo teknike duhet bere pa arritur ne demtimin e materialit.

1.7 Riparime ne raste demtimesh

Gjate kalimit te automjeteve te ndryshme apo punimeve qe mund te ndodhin ne shesh mund te ndodhe dhe demtimi I pllakave apo materialevbe te tjera prej te cilave eshte I perbere sheshi.

Nje rast shqetesues mund te jete ulja e llacit dhe per pasoje dhe thyerja neper cepa te pllakave per shkak te tensionit anesor.

Ne te tilla raste duhet bere nderrimi I pllakes ne baze te ketyre hapave :

- 1.Rrethimi I vendit
- 2.Prerja me gru fleksibel I bojakut te fugave kufitare
- 3.Thyerja me matrapik e pllakave dhe e llacit te cimentos deri ne shtresen e hidroizolimit te betonit
- 4.Pastrim I mire I gropes
- 5.Riberja e hidroizolimit me bikomponent
- 6.Vendosja e llacit te cimentos dhe pllakes se re
- 7.Mbushja e fugave midis pllakave me bojak (ne rast fuge silikoni pas vendosjes se amoflexit ,pjesa e brendshme mbushet me silikon.)

Pertej ketyre situatave nje tjetër problem mund te jete dhe krisja apo carja me e vogel e ketyre siperfaqeve. Ne kete rast kryhet perzierja e stukos se mermerit dhe pasi eshte pastruar vendi vendoset ne te krisuren apo ne te caren e gurit.

Ne rastin e prishjes se asfaltit ndiqen keto hapa:



Demtim i cepave te pllakave te gurit

- 1.Behet prerja me sharre me forme te rregullt katerkendore
- 2.Prishet asfalti brenda prerjes
- 3.Behet pastrimi I gropes se hapur
- 4.Lyhet me primer



Dentim i asfaltit ne sheshin Skenderbej

5.Behet hedhja e asfaltit te ri dhe e gureve kuarcor

2
MIREMBAJTJA E
KANALIZIMEVE

2. SISTEMI I KANALIZIMEVE

2.1 Pershkrim I pergjithshem I sistemit te kanalizimeve

Permasat e sheshit jane 164.16 me 146.16. Duke qene te tilla, pra te kesaj madhesie, rendesi te madhe ka shkarkimi I ujrave te shiut ,por dhe I shatervaneve ,si atyre me rjedhje dhe atyre me hedhje te ujit. Per kete qellim sheshi eshte menduar si nje piramide me kulm ne qender dhe brinje, ne te cilat shkarkojne ujrat e e kater faqeve te piramides, me pjeresi mbi 2% ne fund te te cilave ndodhet nje kanal me gjeresi te futjes se ujit me 2 cm ne gryke ,por qe zmadhohet poshte me nje forme te studiuar qe te mbaje sa me pak mbetje te ngurta, i ashtuquajturi "Gatik" dhe ti percjelle ato ne pusetat e pastrimit te shperndara ne menyre simetrike dhe me tej ne rastin e shirave me te rrembyeshem ne pusetat qendrore e komplekse te shkarkimit. Sheshi ka 4 puseta kryesore te cilat jane komplekse, kryesisht me dy dhoma dhe te pajisura me bllokues elektro mekanik te komanduara elektrikisht nga galixhanat elektrike, qe gjenden ne rezervuarin e ujit te shatervaneve.

Ne rast se nga shiu teper I rrembyeshem kjo valvul elektro mekanike mbyllet , uji kalon ne kanal in me diameter Φ 500 mm, I cili nga ana e tij derdhet ne kolektoret kryesore te qytetit, qe nga ana e tyre derdhen ne lumin e Lanes.

Per shirat normale ,ata te dimrit dhe ujrat e shatervaneve eshte menduar riciklimi I tyre, pasi ujrat shkojne ne puseten kryesore me ane te tubave dhe atje ata pastrohen mekanikisht para se te shkojne ne filtrat e tjere . Keto kater puseta ndodhen : e para ne piken A te sheshit ,pra ne vendin qe ndodhet midis Bibliotekes Kombetare e hotel Tiranes, e dyta ne mes te brinjës AB, e treta ne kulmin C qe ndodhet perballe Bankes Kombetare dhe e katerta ne mes te brinjës CD.

Rreth e rotull sheshit ndodhen gjithashtu dhe pusetat e shkarkimit te ujrave te teperta te lulishteve, kapaket e te cilave jane prej betoni te mbyllura me gjeotekstil ne menyre qe te mos hyjne mbetjet e ngurta ne tubat e shkarkimit , te cilet shkarkojne direkt ne kolektoret e qytetit . Puseta ne brinjen CD, ku shkarkon nje kunete betoni e mbushur me gure zalli te medhenj, e ashtuquajtura kanali francez, qe ben nje lloj filtrimi te ujit, mbledh ujrat e faqes nga lindja dhe I rikthen ne depoziten e shatervaneve. I gjithë ky sistem ben te mundur qe sheshi te mos mbytet as ne pikat e tij me te ulta ,ne rast te rreshjeve me intesitet te larte.

Ne shesh kemi dhe shkarkime te U.Z. per shkak te tualeteve qe jane pozicionuar poshte sheshit, ne katin -1 prane parkimit. Keto jane larguar me tub Φ 300 SN,8 te cilat shkarkojne direkt ne kolektoret e qytetit me ane te dy pompave (nje ne pune dhe nje rezerve). Ne shesh kemi dhe shkarkimet e ujrave te shiut nepermjet pusetave te mbuluara me gur traktolit te Lezhes , te prere si zgare. Keto pasi mblidhen shkarkojne direkt ne kolektorin e qytetit. Keto kuneta dhe puseta jane ndertuar per te shkarkuar ujin e siperfaqeve me asfalt dhe te atyre me beton te lare. Uji mblidhet ne kunetat e ndertuara me gur traktolit e me pas kalon ne puseta e tubat 300mm SN 8

2.1.1 Sistemi I kanalit GATIK

Sistemi I kanalit gatik perbehet nga kanali me formen e tij te veçante per ti dhene shpejtesi ujit duke mos e lene te dekantuje, pusetat per pastrim qe bejne te mundur nje lloj dekantimi dhe nga pusetat kryesore ku shkarkon ky lloj kanali.

Ky lloj kanali eshte I perbere nga tre elemente qe montohen njeri siper tjetrit. Bazamenti me muret derdhen bashke me beton te markes C25/30 dhe me kallep metalik, ne menyre qe faqet e tij te dalin sa me te lemuara dhe mos ti bejne rezistence ujit qe rjedh ne ate, duke mos dekantuar mbetje te ngurta . Gjeresia e ketij kanali eshte 60cm kudo, kurse lartesia ndryshon ne varesi te pjerresise dhe te gjatesise se brinjesh ujembledhese deri te puseta.

Kapaku eshte I konstruktuar me beton te markes C25/30 dhe lidhet po me beton me muret e kanalit duke u monolizuar me hekurat qe jane lene jashte per kete qellim. Ky ka forme te tille qe tu beje balle ngarkesave dinamike , si kalimi I kamioneve nga bulevardi ne shesh dhe ka armimin e duhur per kete qellim.

Gryka eshte nje element I perbere nga 2 L inoksi te larguara 2cm nga njera tjetra te lidhura me distancatore po inoksi ne forme cilindri, per te mos penguar ujin qe pershkon ato dhe qe montohen me kup inoksi ne kapakun e kanalit. Ky profil L perqafohet nga pllaka ne dy drejtimet dhe eshte nje element mjaft I qendrueshem.

Pusetat e kontrollit jane ne permasa me te medha se kanali dhe jane ndertuar per te dekantuar materialet e ngurta qe vijne me shiun dhe si puseta kontrolli per kanalit gatik te shperndara cdo 30m per te bere te mundur qe ne rast bllokimi te kanalit gatik te behet e mundur çbllokimi I tij.



Foto e kanalit Gatik ne fazat e para te ndertimit



Foto e kanalit Gatik gjate procesit te ndertimit

Pusetat kryesore bejne te mundur mbledhjen e ujit te shirave e shatervaneve, dekantimin e mbetjeve te ngurta (pjeserisht) dhe rikthimin e ujit fillimisht ne filtrin mekanik e me pas ne depozite. Gjithashtu me ane te nje elektrovalvule bejne te mundur qe te mbyllin tubin e dergimit ne depo dhe lidhjen ne kete rast me kolektorin e qytetit.




Foto e kanalit francez

2.1.2 Sistemi I kanalit francez

Ky kanal ka perdorim te vogel ne shesh vetem pjeserisht ne brinjen CD ne lindje te sheshit ne 2 krahet e monumentit te Skenderbeut. Ky kanal eshte I perbere nga seksioni I tij prej betoni dhe guret e zallit te nje madhesie prej 90-100mm te cilet sherbejne per filtrimin paraprak mekanik te ujit .Ky uje pasi mblidhet shkon ne tub ne puseten qe eshte ne mesin e brinjes CD e cila shkarkon kolektorin e qytetit.

2.2 Pastrimi I sistemit GATIC

Pastrimi I sistemit Gatic fillon me mbylljen e elektrovalvulave mekanikisht per te bere te mundur qe mbetjet e ngurta te mbeten ne 4 pusetat kryesore.

2.2.1 Pastrimi I kunetes gjatesore te GATIC

Pastrimi i gaticut fillon nga pastrimi i pjeses se siperme pra asaj te Inoksit. Ky pastrim mund te jete mekanik me shpatull ose me dalte ne varesi te trashesise se materialit te grumbulluar. Pastaj me ane te stekes se pompes se lavazhit fillojme pastrimin ne brendesi te eleve dhe me thelle muret dhe me pas dyshemeja ne formen e shkronjes V . E rendesishme ne kete proces per shkak se pamja eshte shume e kufizuar, puntori qe do ta kryeje te jete sa me sistematik Larja te behet ne drejtim te pjeresise pra nga kuota me e larte ne kuoten me te ulet te tabanit dhe deri ne puseten kryesore perkatese.

2.2.2 Pastrimi I pusetave te dekantimit dhe sistemit te rikthimit

Pasi eshte lare pjesa e kanalit mund te behet pastrimi I pusetave te kontrollit dhe pusetes kryesore nga mbetjet e ngurta qe kane dekantuar ,duke I ngarkuar ne kamion e depozituar ne landfillin e qytetit.

Kujdes I veçante duhet treguar qe te mos derdhen dhe te ndyjne hapesirat e sheshit pasi aromat mund te jene veshtiresisht te heqshme.

2.3 Pastrimi I kanalit francez

Pastrimi I kanalit francez fillon me heqjen e gureve te zallit dhe nxjerjen e tyre mbi nje plastmas te trashe te vendosur mbi pllakat e sheshit . Pasi te jete bere kjo pune ne gjithë gjatesine duhet te filloje larja e tyre dhe e kanalit, njekohesisht nga pika me e larte ne drejtim te pusetes kryesore qe gjendet ne mesin e brinjes CD, me pompe lavazhi. Pasi te jete lare behet rivendosja e gureve dhe ne fund pastrimi I pusetes kryesore qe ashtu si dhe ne rastin e kanalit Gatic paraprakisht I eshte mbyllur elektrovalvula. Mbeturinat depozitohen ne landfillin e qytetit.

2.4 Pastrimi I zgarave te shiut

Pastrimi I zgarave te shiut behet ne kohe pa reshje dhe fillon me heqjen e kapakut qe eshte gur traktolit me disa ripa te hequr per kullimin e ujit. Me pas fillon pastrimi I materialeve te ngurta te dekantuar aty . Kjo pune behet me nje lloj shati te krijuar per kete pune . Mbeturinat depozitohen ne landfillin e qytetit. E rendesishme eshte qe pas pastrimit te behet larja e pusetes per nje pastrim me te mire e per te shmangur aromat e




Zgarat e shiut

3
MIREMBAJTJA E
NDRICIMIT

3. NDRICIMI

Ndricimi i perdorur ne sheshin Skenderbej eshte i nje varieteti shume te madh, qe nga ndricuesi shtylle, spot, neon, sheirit led, mural. Ne harten e meposhteme jane specifikuar pozicionet, dhe legjenda per secilin lloj.



Plani i ndricimit ne Sheshin Skenderbej

LIGHTING PUBLIC SPACE	
	Fundore dhe kapele qndrojtore
	Fundore dhe kapele qndrojtore
	Fundore dhe kapele qndrojtore
	Enthecentim, her shprehje
	Blerje dhe shprehje * Pote rreth 100 cm dhe 200 cm
	Shprehje dhe shprehje
	Plazat dhe shprehje
	Aksione dhe shprehje
	Aksione dhe shprehje
	Aksione qndrojtore dhe shprehje * Pote rreth 100 cm dhe 200 cm
	Udhëzime dhe shprehje
	Fundore dhe shprehje
	Pozicionet dhe shprehje
	Elektronik
	Pozicionet dhe shprehje

Legjenda e planit te ndricimit


ENHANCEMENT LIGHTING HERITAGE	
PALACE OF CULTURE - COFFEE	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
NATIONAL MUSEUM	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
	Enthecentim dhe shprehje
	Enthecentim dhe shprehje
PUPPET THEATRE	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
	Enthecentim dhe shprehje
	Enthecentim dhe shprehje
MOSEUM	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
	Enthecentim dhe shprehje
	Enthecentim dhe shprehje
CLOCK TOWER	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
	Enthecentim dhe shprehje
	Pozicionet dhe shprehje
MINISTRIES	
* Pote rreth 100 cm dhe 200 cm	
	Enthecentim dhe shprehje
	Enthecentim dhe shprehje

Legjenda e planit te ndricimit

3.1 Llojet e ndricimit te perdorura ne Sheshin Skenderbej

3.1.1 Ndricules (Tipi M1)

Ky ndricues eshte i larte 7.8 metra. Eshte nje lloj ndricuesi i asmbeluar nga 2 elemente te vecante, shtylla dhe spotet per ndricim. Eshte i perbere nga 3 spote dhe i pozicionuar ne disa vende te ndryshme ne Sheshin Skenderbej si pershembull, anash Bankes se Shqiperise, para hotel Tiranes



Ndriculesi i tipit M1, me 3 koka te montuara ne shtylle



Lloji i kokes se perdorur ne ndricuesit e larte

3.1.2 Ndricules (Tipi M2)

Ky tip ndricuesi eshte si ndricuesi me siper (Tipi M1) por ne ndryshim ka 6 koka me llampa. Sic e theksuam dhe me siper eshte i assembluar nga shtylla qe vjen si element me vete dhe kokat e ndricuesit

Shtylla me 6 ndricues jane perdorur perreth Sunken Garden (hapesira e gjelberuar me e madhe e Sheshit Skenderbej), pergjate bulevardit nga Sunken Garden deri tek ministria e transportit, dhe pergjate bulevardit nga hapesira kryesore e Sheshit Skenderbej deri ne fund te Muzeut Kombetar.

Me poshte do listojme disa karakteristike te 2 tipeve te ndricuesve te perendur me siper. Ndricules i tipit spot i dizenuar per te funksionuar me ndricim te ngrohte. Mund te instalohet ne toke, ne mure, apo ne nje sistem shtylle sic eshte dhe rasti jone. Vete spoti konsiston ne nje lloj assemblazhi sic eshte kutia kryesore, xhami, korniza metalike e cila mban xhamin, dhe krahu. Procesi i lysterjes behet me primer dhe boje likuide akriliku e kuruar ne 150 grade celcius, e cila eshte rezistente e motit dhe e rezeve UV. Xhami eshte i temperuar, i trashe 4mm dhe transparent.

Me poshte listohen karakteristika e dy tipeve te mesiperme, M1 dhe M2

Marka e produktit – Iguzzini

Kodi i produktit – BV05

Dimensionet – Φ 315x319


Ngjyra – gri

Pesha – 7.6kg

Intensiteti i ndricimit – 6720 lumen

Temperatura ambjentit – 25-35 grade

Jetegjatesia – 100.000 ore pune




Ndricules i tipit M2 me 6 koka te montuara ne shtyllle

3.1.3 Ndricules (Tipi M3)

Ne planin e ndricimit me siper eshte specifikuar dhe nje ndricues ne ngjyre blu, ndricues (Tipi M3). Ashtu si tipi M1 eshte i perbere nga shtylla dhe 3 ndricues te tipit spot, por ne ndryshim nga te tjeret njeri nga spotet eshte RGB

Ky tip ndricuesi ne sheshin Skenderbej, eshte i pozicionuar : ne kopershtin mes Bankes se Shqiperise dhe Muzeut Kombetar, mbrapa Muzeut Kombetar, mes hotel Tiranes dhe Muzeut Kombetar

Ka te njejtat karakteristika si ndricuesi i Tipit M1 dhe Tipit M2



Ndriculesi i tipit M1



Ndriculesi i tipit M2

3.1.4 Ndricules (Tipi TR1) – Ndricimi I pemeve nga toka


Modeli I ndricuesit, Model – Naboo 534043, marka ARES

Pjesa e siperme e ndricuesit - Material policarbonat kundra rrezeve UV, 15mm I trashes, ne pergjithesi rezistent ndaj vandalizmave

Pjesa e trupit te ndricuesit – material alumin

Orientim I rregullueshem ne nje rrotullim prej 360 grade

Pllaka paralele me perkulje të pavarur të rregullueshme me vida dhe pa çmontim te projektorit. (-3 ° / + 26 °)



Skeda teknike e ndricuesit tip spot te perdorur per ndricimin e pemeve



Skema e ndricimit te pemeve




Kendi i ndricimit




Ndricules i tipit spot per ndricimin e pemeve


3.1.5 Ndricules (Tipi SK3)



Skeda teknike e ndricuesit te tipit spot te perdorur per ndricimin e statujes se Skenderbeut



Ndricimi i statujes se Skenderbeut



Ndricimi i statujes se Skenderbeut

Ky ndricues i tipit spot eshte i vendosur perreth statujes se Skenderbeut per nje theksim sa me te mire te bustit

Ndricules tip spot me karakteristikat e meposhtme:

Projektor LED inkaso per ndricimin e siperfaqeve apo objekteve vertikal. Mbulimi i llampes eshte nje aliazh bronxi masiv.

Marka e produktit – BEGA

Kodi i produktit - 77819

Lloji I llampes – 1 x LED max 10.5E

Tensioni I lidhjes – 230Volt

Ngjyra e ndricimit – 3000K , e bardhe e ngrohte

Perdorimi – I jashtem


Dimensionet e produktit – $\Phi 290 \times 170$ mm

Dimensionet e brendeshme – $\Phi 290 \times 120$ mm

Ngjyra e trupit te ndricuesit – bronx

Jetegjatesia – 50.000 ore pune

3.1.6 Ndricules (Tipi PTC1)



Menyra e ndricimit te koridorit mes teatrit te kukullave dhe ministrise

Ky ndricues eshte i vendosur vendosur ne toke ne koridorin mes teatrit te kukullave dhe ministrise, gjithashtu dhe per ndricimin e fasades anesore te teatrit kukullave

Ky ndricues linear, me rreze te larte eshte projektuar posacerisht per te lejuar rregullimin e kendit ne vend, pa cenuar hidroizolimim. Sistemi I ketj ndricuesi Brenda nje capsule e ben rezistent ndaj vandalizmave. Gjithashtu duke pasur gjeresine e kanalit ku kalojne dhe kabllat nuk ka nevojte per vida. Shpesh here ky lloj ndricuesi I reziston dhe pershes se makinave per siper.

Karakteristika te vecanta:

Marka e produktit – SIDE, LONGLIGHT ECO

Kodi i produktit –E8951AS-LBC-18

Materiali I trupit – alumin I anodizuar, I disponueshem ne 2 gjatesi, 50cm dhe 100 cm

Pjesa e sipërme e perbere nga material xhami organic I trashe 12mm


Per lente sa me simetrike duhet te percaktohet orientimi ne lidhje me aksin e rrotullimit

Tensioni – 220-240volt

Pesha – 5.5kg

Fluksi i ndricimit – 1788.9 lumen

Jetegjatesia – 50.000 ore pune



Ndriculesi i perdorur per teatrin e kukullave



Ndriculesi i perdorur per teatrin e kukullave

3.1.7 Ndricules (Tipi PRK1)


Ky tip ndricuesi eshte i vendosur ne pandusin e parkimit nentokesor. Ndricules mural ne forme katrore, i perbere nga materiali resine e cila duron goditjen. Si standart prodhohet me 2Xgx53 llampa LED me shume jetegjatesi.

Marka – Fumagalli

Kodi i produktit – LETI 300

Nderrim llampe shume i thjeshte


Material resine qe duron goditjet



Ndriculesi i perdorur per rampen e parkimit



Ndriculesi i perdorur per rampen e parkimit



Ndriculesi i perdorur per rampen e parkimit

3.1.8 Ndricules (Tipi PRK2)

I vendosur ne muret dhe ne shkallet e parkimit. Kudo ku ka shkalle qe zbresin nentoke ne sheshin Skenderbe eshte i kontuar ky lloj spoti



Ndriculesi i perdorur per ndricimin e shkalleve te parkimit

Ndricules I tipit spot, I perzgjedhur ne menyre te tille qe most e jete shqetesues per kalimtare, duke qene se eshte nje ndricues qe do vendoset ne toke

Karakteristika te vecanta:

Marka – BEGA

Kodi i produktit - 22369

Materiali: hekur I paoksidueshem, alumin, metal dhe xham

Diametri I pjese se dukshme te ndricuesit: 8cm

Diametri I pjese se padukshme qe futet ne shkalle: 7.1cm

Thellesia e pjese se ndricuesit qe zhytet: 8cm

Pesha: 0.25kg

Drejtimi I drites: Ndricim I orientuar per poshte

Orientimi I drites: I pandryshueshem


Eficenca: Kjo llampe permban module LED te integruar te cilat I perkasin klasit A, A+, A++

Fuqia: 21 eat

Fluksi I ndricimit: 245 lumen

Temperatura e nxehtesise: 3000 kelvin – e bardhe e ngrohte

Jetegjatesia – 50.000 ore pune



Ndriculesi ne shkallet e parkimit

3.1.9 Ndricules (Tipi PT1)

Ndricim grafik , I cili ben theksimin e mureve te brendeshme per nje atmosphere me int ime dhe getesuese.

I perdorur ne kopeshtin ceremonial

I montuar ne toke per theksimin e elementeve kryesor te teatrit te kukullave

I montuar ne toke per ndricimin e te katra fasadave te xhamise se Ethem Beut

Model Uplight 260 – Meyer

Karakteristika te vecanta:

Materiali I trupit celik, rezistent ndaj korozionit


Ngjyra – e zeze

Ndricimi – Led, I bardhe I ngrohte


Fuqia – 37 eat

Shprendarja – Rreze ngushte, rrotullim simetrik

Fluksi I ndricimit – 3133 lumen



Skema e ndricimit ne dhomen e ceremonise



Ndriculesi i perdorur ne dhomen e ceremonise



Ndriculesi i perdorur ne dhomen e ceremonise

3.1.10 Ndricules (Tipi OP1)

Teatri I Operas dhe Baletit – per ndricimin e monumenteve historike. Vendosen ne fasade, ne pjesen e sipërme te dritareve

Karakteristika te vecanta:

Marka – BEGA Kodi i produktit - 24362

Tipi I llampes – 1x LED me fuqi maksimale 33.6E

Klasi energjise – A++

Fluksi I ndricimit – 4645 lumen

Ngjyra e ndricimit – 3000k, e bardhe e ngrohte

Perdorimi – I jashtem

Montimi – Montohet ne siperfaqe te sheshta

Permasat – 190x320x105


Materiali – Alumin plus xham



Ndriculesi Tip OP1



Skema e ndricimit ne Teatrin e Operas dhe Baletit



Ndricimi ne Teatrin e Operas dhe Baletit



Ndricimi ne Teatrin e Operas dhe Baletit

3.1.11 Ndricules (Tipi OP2)

Ky lloj ndricuesi eshte I vendosur ne kolonat e Teatrit te Operas dhe Baletit, dhe ka ndricim direct dhe indirekt. Eshte i projektuar ne menyre te tille qe te te ndricoje ne 2 ane, dhe pjesen siper dhe pjesen poshte. Materiali i projekteve i perbere nga pluhur poliester dhe grafit, ne ngjyre te zeze dhe te bardhe.

Karakteristika te vecanta:

Marka – BEGA

Kodi i produktit - 33387

Drejtimi i drites – 2 drejtime, siper dhe poshte



Orientimi i dreites – fiks

Eficenca – module LED te klasit A, A+, A++


Fuqia – 86.8 eat

Fluksi i ndricimit – 10.260 lumen

Temperatura e nxehesise – 3000k, ngjyra e bardhe e ngrohte



Ndricules i perdorur ne kolona e TOB




Ndricules i perdorur ne kolona e TOB

3.1.12 Ndricules (Tipi OP3)

Teatri I Operas dhe Baletit – per ndricimin e monumenteve historike. Ndricules shirit qe vendoset ne hyrje te monumenteve, i perdorur gjithashtu ne kornizat e sipërme te ministrive ne fasadat kryesore.

Lloj ndricimi ky shume komod duke qene se eshte shume fleksibel dhe i pershtatet formave te deshiruara

Ngjyra e ndricimit – 3000k
Fuqia – 28eat



Ndricules i tipit LED shirit

3.1.13 Ndricules (Tipi MU1)

Eshte perdorur per ndricimin nga siper te xokolatures se muzeut, ka nje shprendarje drite asimetrike. Materiali i kutise eshte aliazh alumini dhe hekuri

Ndricules per perdorim te jashtem, per tu monutar ne mure. Burimi i drites eshte LED

Marka- BEGA

Kodi i produktit - 33238

Temperatura e nxehtesise – 3000k, ngjyra e bardhe e ngrohte

Ngjyra e materialit – gri

Tipi i llampes – LED

Dimensionet – 20x13.5x20cm

Kendi i ndricimit – 60 grade

Fluksi i ndricimit – 1577 lumen

Jetegjatesia – 50.000 ore pune



Ndricules i perdorur per theksimin e frizit



Ndricules ne Muzeun Kombetar



Ndricules ne Muzeun Kombetar

Muzeu Kombetar

3.1.14 Ndricules (Tipi MU2), ne kolonat e muzeut

Ne te njejten menyre si tek kolonat e teatrit e operas dhe baletit, do vendoset ndricim dhe ne kolonat e museut. Ndricimi eshte bere me ndricues mural si me siper

Karakteristika te vecanta:

Marka – BEGA

Kodi i produktit - 22386

Drejtimi i drites – Ndricon vetem nga poshte

Pesha – 3.1kg

Orientimi i drites – fiks, i pa ndryshueshem

Eficienca – Kjo llampe permban module LED te cilet bejne pjese ne klasin energjitik A, A+, A++

Fuqia – 25.3vat

Fluksi i ndricimit – 2.685 lumen



Ndricules i perdorur ne kolonen e Muzeut Kombetar



Ndricules i montuar ne kolonat e MK



Ndricules i montuar ne kolonat e MK

3.1.15 Ndricules (Tipi MU3)

Ky ndricues eshte i vendosur ne toke, ne fasaden kryesore te muzeut, dhe gjithashtu perdorur per te ndricuar te gjitha fasadat kryesore te ministrive perreth sheshit Skenderbej. Ne kete rast projektori eshte brenda nje kutie hekuri te mbuluar me xham te temperuar 23mm, me permasa 500x350x480, e cila eshte e zhytur ne toke. Eshte i perbere nga 42 llampa LED shume te fuqishme, por ne realitet ndricuesi eshte nxjerr nga kutia pasi nxehtesia e llampes shkrin materialin transparent.



Ndricules prozhektor

Karakteristika te vecanta:

Marka – LEC Lyon

Kodi i produksit – Corsica 4660

Modul LED ne alumin te derdhur

Dritare polikarbonati 8mm – me mbrojtje UV, rezistente ndaj vandalizmave

Krahu – nje aliazh alumini i cili perfundon me saten, max 1 meter gjatesi

Fluksi i ndricimit – 6300 l



Ndricules i tipit prozhektor i perdorur per ndrcimin e fasadve rreth Sheshit Skenderbej

3.1.16 Ndricules (Tipi MU7)

Nje nga projektoret me te fuqishem i perbere nga 16 llampa LED, i cili eshte shume i pershtatshem per theksimin e detajeve.

Ky prozhektor eshte i montuar ne shtylle dhe i perdorur per ndricimin ballor te mozaikut te Muzeut Kombetar, i montuat ne te kater cepat e catise se xhamise se Ethem Beut per te ndricuar kupolen e xhamise, dhe per ndricimin e sahatit te Tiranës. I vendosur ne taracat e ministrive perreth dhe drejtuar perseri nga sahati i Tiranës

Marka – LUMENBEAM


Xham i temperuar

Jetegjatesia – 120.000 ore pune

Reze te gjere shprendarje drite

Intensitet ndricimi deri ne 2676 lumen


16x2.5E LED te performances se larte



Skema e ndricimit te mozaikut te Muzeut Kombetar



Ndricules tip prozhektor



Skeda teknike e ndricuesit



Ndricuesi i tipit prozhektor, i perdorur per theksimin e detajeve arkitektonike ne te gjitha fasadat rreth Sheshit Skenderbej

3.1.17 Ndricules (Tipi MU4)

Ndricules i tipit LED shirit, i perdorur ne fasaden kryesore te muzeut. Gjithashtu perdorur ne ballkonin e sahatit te Tiranes. Perdorimi – e perkoheshme , pershembull nga perendimi deri ne mesnate



Ndricules i tipit LED shirit i perdorur ne fasaden e Muzeut Kombetar

3.1.18 Ndricules (Tipi MU5)

Ndriculesi me siper eshte perdorur per theksimin e mozaikut ne Muzeun Kombetar, dhe gjithashtu per ndricimin e sahatit te Tiranes

Marka – MEYER

Kodi i produktit – NANO 4


Perbere nga 16x2.5e llampa LED

Kutia e jashtme material hekuri

Xham i temperuar



Ndricules i tipit prozhektor i perdorur ne fasaden kryesore te Muzeut Kombetar



Skeda teknike dhe foto e ndricuesit me siper

3.1.19 Ndricules (MU6)

Ndricules i tipit neon i perdorur per te theksuar me shume mozaikun ne pjesen e sipërme. I vendosur ne taracen e Muzeut Kombetar

Neon me diameter 70mm, material polikarbonat me cilesi kristali



Skema e ndricimit te cepave te mozaikut



Ndriculesi tip neon i tipit MU6

3.1.20 Ndricules (KC1)

Ky lloj ndricimi eshte i perdorur te skena. Hapesira mbas kopeshtit ceremonial. Lampa e perdorur – Zafiro LED e cila ofron me te miren e teknologjise LED, zgjidhja me e mire per rastete kur lampa duhet te jete e dukshme



Ndricim zinxhir i perdorur ne pjesen e skenes

3.1.21 Ndricules (KC2)


Ky ndricues eshte i vendosur ne kopeshtin e ceremonive
Ndricules i dizenuar per tu montuar ne tavane, mure dhe kolona.

Kodi i produktit – 44769

Marka e produktit – BEGA

Materiali i perbere nga aliazh alumini dhe hekuri

Fuqia e ndricimit eshte ne varesi te llampes se perdorur



Ndriculesi ne kopeshtin ceremonial



Lloji i ndricimit i perdorur ne kopeshtin ceremonial

3.2 Mirembajtja e ndricimit

Te gjithë ndricuesit e perdorur ne sheshin Skenderbej, jane ndricues te prodhuar nga marka prestigjoze. Kane jetegjatesi nga 50.000 ore deri ne 120.000 ore pune, ne varesi te llojit. Ne pergjithesi jane rezistent ndaj vandalizmave. Fiken dhe ndizen me sensor , per te mos harxhuar energji elektrike te tepert, ndizen ne perendim te diellit, dhe fiken ne lindje te diellit. Nderkohe ne periudhem mes perendimit dhe lindjes se diellit mund te luhet me intensitetin e ndricimit, si me poshte

3.2.1 Perendim - Mesnate

Nga perendimi I diellit e deri ne mesnate, numri I njerezve ne Sheshin Skenderbej eshte I larte. Te gjithë tipet e ndricuesve do jene te ndezur, ndrizimi funksional, ndricim ambjenti, ndricimi I monumenteve historike dhe ndricimi I vegjetacionit. Duhet ti jepet prioritet ndricimit te ambjnetit, ndricimit te vegjetacionit dhe ndricimit te monumenteve historike. Intensiteti I ndricimit funksional mund te zvogelohet dhe te pershtatet ne nje nivel me te mire.

3.2.2 Mesnate – 2AM

Nga mesnata deri ne oren 2 te mengjesit (pershembull) fluksi I njerezve ne shesh eshte I ulet. Ne kete periudhe ndricimi ambjentit, I vegjetacionit dhe I monumenteve historike fiket, dhe ngrihet pak fluksi I ndricimit funksional. Kjo sherben dhe per konsum energjie

3.2.3 2AM – 5AM

Nga ora 2 deri ne oren 5 te mengjesit, fluksi I njerezve ne shesh eshte shume I ulet, pothujse zero. Atehere ulet intensiteti indricimit funksional dhe konsumi I energjise eshte me I madh.

3.2.4 5AM – Lindje dielli

Nga ora 5 e mengjesit deri ne lindjen e diellit, fluksi I njerezve ne shesh fillon te rritet dhe ne te njejten kohe duhet te rritet dhe intentsiteti I ndricimit funksional.

3.3 Stafi mirembajtes i ndricimit

3.3.1 Elektricisti

Sa here ka qene e nevojshme marja e eenrgjise elektrike ne Sheshin Skenderbej per arsye te ndryshme, ne pjesen me te made te rasteve humbin morsetat dhe vidat e shtyllave te ndricimit. Edhe kur nuk humbin prishen apo shtremberohen pasi nuk hapen ne menyren e duhur. Eshte kusht qe sa here ne rast te nje eventit apo ne raste te tjera kur duhet energji elektrike nga Sheshi Skenderbej do te njoftohet me pare firma mirembajtese qe elektricisti te jete ne terren. Te udhezoje personat e interesuar se nga ku mund te meret energjia eletrike, nga shtyllat apo nga panelet te cilat jane te vendosura ne sheshin Skenderbej pikerisht per te shprendare energji elektrike.

Do jete elektrikisti i punesuar nga firma mirembajtese, i vetmi qe do kete te drejte per hapjen dhe mbydhjen e panele, dhe i vetmi qe do kete aksesin per te bere lidhje elektrike te perkoheshme.

- Ne rastin e hapjes se shtyllave ne menyre te gabuar, morsetat prishen ose humbin, dhe ne pergjithesi vidat humbin. Ne kete rast jane te nevojshme riparimet apo zevendesimet e morsetave dhe vidave per mos ti lene shtyllat e hapura

- Ne raste te nje lidhje te gabuara,nga pakujdesia ka ndodhur qe te jete keputut i gjith kablli i shtylles, i cili duhet te zevendesohet menjehere per te rikthyer ndricimin


- Ne raste te nje lidhje te gabuar mund te degjet automati kryesor, mungesa e te cilit e le te gjithe sheshin ne erresire, ne nje rast te tille eshte shume emergjent nderrimi qe ti kthehet ndricimi sheshit.

- Te gjithe ndricuesit e perdorur ne sheshin Skenderbej, sic e permendem dhe me siper jane ndricues shume cilesor. Kane jetegjatesi nga 50.000 – 120.000 ore pune. Nese ndodh qe ndonje nga ndricuesit te digjet, ne pjesen me te madhe te tyre eshte i pamundur zevendesimi i llampave. Pra nese perballemi me fenomenin e djegjes, ndricuesi duhet nderruar i gjithi si trup. Zevendesimi do behet sipas markave dhe kodit te produktit qe aktualisht jane perdorur ne shesh. Te gjitha te dhena te specifikuara ne kapitullin e mesiper.

- Ne rast se ne nje lidhje elektrike nuk perdoret kabulli i duhur, me trashesine e nevojshme per te perballuar fuqine, atehere rrezikon te bie automati i te gjithe ndricimit te sheshit.

- Komandimi i ndricimit behet nga panelet e vendosur ne dhomen teknike, e cila do sqarohet ne nje kapitull tjeter, por ndricuesit njehere te ndizen nuk kane me nevoje te fiken, pasi fiken dhe ndizen me sensor sipas lindjes dhe perendimit te diellit.

- Nje pjese shume e rendesishme e mirembajtjes se ndricimit, eshte dhe mirembajtja e paneleve elektrik, te cilet jane dhe pikat ku lejohet te meret energji. Panelet e shprendare ne shesh jane 3 te medhenj dhe 9 te vegjel. Nuk lejohet te hapen nga njerez te paautorizuar pasi mund te demtojne panelet. Me poshte skemat e te 2 paneleve te perdorur.



Gjithashtu do ilustrohen me foto demtimet qe jane bere deri me sot per sa i perket ndricimit, si ne panele ashtu dhe ne shtyllat e ndricimit nga nderhyrja e personave te paautorizuar. Ne legjende keto panele jane te shenuat me E ne ngjyre blu. 3 panelet e medhenj jane te vendosur anash bankes se Shqiperise, tek shkallet e Muzeut Kombetar nga ana e bulevardit dhe mbrapa dhomes teknike.

Nente panelet e vegjel jane te shprendare neper shesh, si pergjate bulevardit, panelet ne kopeshtin e ceremonive, mes xhamise dhe Teatrit te opera dhe baletit etj.

Per te shmangur te gjitha problemet e listuara me siper, dhe per te shmangur deme te panevojshme atehere nje elektrikist i autorizuar do te jete prezent ne terren sa here te jete e kerkuar nga subjektet me leje te Bashkise Tirane. Askush tjeter pervec elektrikistit nuk eshte i autorizuar te preke panelet apo te beje lidhje elektrike te perkoheshme.


Me poshte do listojme disa foto te demeve te bera gjate kohes.




Demtime te paneleve gjate kohes



Demtime te paneleve gjate kohes



Demtime te paneleve gjate kohes



Demtime te paneleve gjate kohes

4
MIREMBAJTJA E
GJELBERIMIT

4. MIREMBAJTJA E GJELBERIMIT

4.1 Grupi i punes

4.1.1 Parathënie për mirëmbajtjen e gjelbërimit

Bimësia e rripit të gjelbër që rrethon sheshin Skënderbe ka një ndërtim shtresor dhe përbërje të shumëllojshme. Janë përdorur më shumë se 150 specie të pemëve, shkurreve, luleve, hardhi, zhardhok dhe një/ dy vjetore. Një shtresim vertikal është aplikuar ku pemët përbëjnë shtresën kryesore që strehon nënshtresat që përbëhen nga shkurre dhe bimë të ulta shumëvjeçare. Përdorimi i llojeve gjetherënëse dhe gjelbërim gjithëvjetor në pemë, shkurre dhe shtresa bimësh të ulta shumëvjeçare siguron një pamje të gjelbër gjatë gjithë vitit dhe një sfond të bukur për një sërë specimesh të ndryshme që lulëzojnë dhe ofrojnë aroma të ndryshme përgjatë vitit. Bimët dhe pemët janë renditur në një mënyrë shumë natyrore që lejon bimësinë të zhvillohet gjatë gjithë kohës. Kjo do të thotë që bimësia duhet të mbikëqyret me kujdes dhe të udhëhiqet në drejtimin e duhur për t'u bërë më e pasur, më e larmishme dhe më e bukur përgjatë kohës.

4.1.2 Ekipi dhe pajisjet

Ekipi i punëtorëve me mbikëqyrësit e tyre është aspekti më i rëndësishëm i mirëmbajtjes, pasi maturimi i dëshiruar dhe qëndrueshmëria e gjelbërimit është pothuajse plotësisht e varur nga aftësitë, njohuritë dhe mirëfunksionimi i këtij ekipi. Kjo nënkupton jo vetëm njohjen e specieve, formën e tyre, zakonet e tyre dhe skemat specifike të mirëmbajtjes së tyre, por edhe dhënien e informatave publikut për të siguruar respekt dhe kuptim të kësaj qasjeje bashkëkohore të hapësirës publike.

4.1.3 Përbërja e ekipit

Ekipi përbëhet nga 10 punëtorë dhe një mbikëqyrës. Punëtorët duhet të jenë të specializuar në kategori të ndryshme të bimëve dhe mirëmbajtjes, me së paku dy punëtorë për kategori: bimë të ulta shumëvjeçare, shkurre dhe pemë, bimë tropikale dhe hardhi, pastrim nga barërat e këqija, mirëmbajtje lëndinë.

Brenda çdo kategorie, punëtorët kanë njohuri të thella për teknikat e përgjithshme të mirëmbajtjes, teknikat e krasitjes dhe njohjen e sëmundjes së kësaj kategorie të veçantë. Megjithatë, shpërndarja e kategorive nuk nënkupton një rol fikse për punëtorët: në periudha specifike, të gjithë punëtorët duhet të jenë të aftë të bëjnë detyra të tjera, p.sh. përgatitja për pranverën, dhënia e ujit në rast dështimi të vaditjes, kontroll dhe mbrojtje gjatë organizimeve të mëdha, pastrim kur merr përhapje një specie invazive etj. Ngarkesa e punës duhet të jetë e balancuar dhe e mirëshpërndarë brenda ekipit.

Të gjithë punëtorët duhet të jenë të aftë të shohin probleme të mundshme: keqfunksionim i sistemit të ujitjes, probleme në rritjen e vegjetacionit dhe për çfarë arsye. Problemet duhet t'i raportohen menjëherë mbikëqyrësit, në mënyrë që masat të ndërmerren sa më parë.

Mbikëqyrësi duhet të ketë njohuri të thella të të gjitha aspekteve të mirëmbajtjes së vegjetacionit dhe sistemit të ujitjes. Ai është përgjegjës për shpërndarjen e detyrave ditore të punëtorëve, një zgjidhës i mirë problemesh dhe ndërmjetësues me të interesuar të tjerë. Ai është gjithashtu partneri qendror i komunikimit për publikun dhe është gjithë kohën me punëtorët e tij në zonën e projektit. Problemet e sjelljes së publikut duhet t'i raportohen mbikëqyrësit, por nuk

është detyrë e ekipit të ndërhyjë, siç janë edhe autoritete të tjera.

4.1.4 Provë për kapacitetin

Për të përmbushur kërkesat e studimit duhet të provohet se ka kapacitet që ekipi të jetë në gjendje të kryejë me sukses të gjitha aspektet e mirëmbajtjes. Një program trajnimi duhet të propozohet dhe miratohet nga qyteti që të edukojë ekipin me këto njohuri shumë të specializuara.

Për vitin e parë, duhet të sigurohet dhe të miratohet nga qyteti një përshkrim për planin si do të organizohet mbikëqyrja. Brenda vitit të parë, duhet të shkruhet një program i aplikuar për mbikëqyrjen e një mirëmbajtjeje të qëndrueshme për vitet në vijim.

4.2 Seti i pajisjeve

4.2.1 Pajisjet

Të gjitha pajisjet duhet të jenë të një cilësie të mirë për përdorim afatgjatë dhe me një standard të mirë ergonomik. Burimet nuk duhet të kursehen në këtë çështje, sepse kjo është nevojë themelore për punë të mirë.

4.2.2 Mjete të vogla

Duhet të sigurohen në sasi dyfishe: lopatë, grabujë (të vogla dhe të mëdha), gërshërë krasitjeje (e vogël dhe e madhe), kovë dhe karrocë dore.

Për secilin punëtor duhet të sigurohet: dorashka dhe rroba të përshtatshme pune.

4.2.3 Mjete të mëdha

Një shkallë dhe një platformë lartësie në gjendje të mirë janë të nevojshme për punë të sigurtë në kurorat e pemëve dhe hardhitë e pergolës.

4.2.4 Pajisje për kositje

Lëndinat tek Sunken Garden dhe në krah të shkallëve të Muzeut Kombëtar duhet të kositen një herë në javë nga marsi deri në fund të nëntorit. Është e rëndësishme që ato të duken të përsosura për kontrast nga vegjetacionet natyrore që rrethojnë këto 'qilima të gjelbër'. Në sezonin e dimrit, kositja është e mjaftueshme kur lëndina është rritur për shkak të motit të ngrohtë. Një makinë kositjeje me funksionim të mirë dhe e mirëmbajtur është një mjet bazë i domosdoshëm.

Lëndinat janë zonat e vetme të vegjetacionit që kanë nevojë për ushqyes: në fillim të sezonit të rritjes, fundi i qershorit dhe fundi i shtatorit (shih kapitullin 'furnizimi me materiale'). Kjo mund të realizohet me dorë.

Barërat e këqija në lëndinë duhet të hiqen me dorë dhe një thikë të vogël nga momenti që shfaqen. Është thelbësore të parandalohet lulëzimi dhe rënia e farave. Asnjë pesticid nuk lejohet në asnjë rrethanë.

4.2.5 Pajisjet e transportit

Ekipi duhet të ketë një kamion të vogël për transportin e materialit. Kjo duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës për shkak të nevojave të papritura në një moment.

4.2.6 Rroba pune

Si pikë kontakti me publikun, punëtorët duhet të kenë një pamje të pastër me rroba të dallueshme dhe cilësore për çdo mot dhe këpucë sigurie. Duhet të bëhet një propozim për këtë dhe të miratohet nga qyteti.

4.2.7 Vendi i depozitimeve

Në bashkëpunim me qytetin e Tiranës duhet të sigurohet një depo për stoqet. Këtu punëtorët mund të ndryshojnë rrobat, mund të pastrohen dhe të mbahen mjetet. Idealisht ky është një vend që nuk është vetëm funksional, por edhe estetik, ku vizitorët e sheshit mund të gjejnë informacion rreth projektit, gjelbërimit dhe biodiversitetit të sheshit. Mund të jetë edhe një vend ku njerëzit mund të blejnë bimë, duke marrë kështu një pjesë të bukurisë së sheshit në shtëpi.

4.2.8 Mirëmbajtja e pajisjeve

Pajisjet dhe mjetet duhet të jenë gjithonë të mirëmbajtura dhe të pastra.

4.3 Ndjekja dhe monitorimi

Si pjesë e programit të mirëmbajtjes duhet të përcaktohet monitorimi.

4.3.1 Monitorimi i zhvillimit të vegjetacionit

Tre herë në vit krijohet një raport monitorimi i cili përshkruan bollëkun e llojeve të ndryshme (shtresa e bimëve të ulta shumëvjeçare) dhe përshkruan shëndetin e shtresës së shkurreve dhe pemëve dhe kjo për zonat e ndryshme të rripit të gjelbër. Monitorimi i mundëson ekipit që të udhëheqë mirëmbajtjen në drejtimin e duhur për të bërë vegjetacionin më të bukur dhe të fortë.

4.3.2 Monitorimi i biodiversitetit

Gjatë gjithë vitit dhe në varësi të motit dhe specieve të monitoruara, është krijuar një studim i biodiversitetit. Ky studim duhet të regjistrojë të gjitha llojet e vertebrorëve të pranishëm, si dhe lloje të vlefshëm invertebror si fluturat, bletët dhe grenzat.

4.3.3 Raporti

Një herë në vit, informacioni i monitorimit përpilohet në raport: ai përshkruan të dhënat e monitorimit dhe reflekton për pasojat e të dhënave. Ai përshkruan programin e planit të mirëmbajtjes së viteve të ardhshme me të gjitha punët e parashikuara, duke përfshirë

materialet, materialet bimore, ...

Ky raport duhet të krijohet gjatë sezonit të dimrit dhe të dorëzohet në fillim të shkurtit.

4.3.4 Punët e përgjithshme

Punët e përgjithshme që duhet të bëhen në gjelbërim përfshijnë pastrimin e barërave të këqija, mbushje me ashkla pishe, mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe përdorimin e kimikateve dhe plehrave kimike.

4.4 Pastrimi i barërave të këqija dhe Mbushje me ashkla pishe

Me kalimin e kohës, bimët do të sigurojnë një mbulesë të plotë tokësore që kufizon shtimin e barërave të këqija: shumica e tyre duan dritë për të kapërcyer fazën e gjumit. Megjithatë në fazën e parë, ku bimësia nuk është zhvilluar plotësisht, pastrimi i barërave të këqija është me rëndësi themelore.

Punëtorët përgjegjës për pastrimin e barërave të këqija duhet të jenë të vetëdijsëm për të gjitha speciet e mbjella, llojin e filizave të rinj që nuk duhet të pastrohen dhe të jenë në gjendje të njohin barërat e këqija të ndryshme (invazive) nga faza e e parë e shfaqjes deri në fazën e rritjes së plotë. Heqja duhet të bëhet me kujdes pa dëmtuar vegjetacionin. Barërat e këqija duhet të hiqen para se të mund të hedhin farat dhe gjithmonë me heqjen e plotë të sistemit rrënjësor. Sidomos me speciet invazive, si *Elitrychia repens*, vëmendja duhet t'i kushtohet heqjes së plotë të rrënjëve. Të gjitha barërat e këqija duhet të hiqen nga zona.

Pas pastrimit të kujdesshëm të barërave të këqija dhe pastrimit të përgjithshëm të pranverës mund të aplikohet një shtresë ashklash pishe. Kjo shtresë nuk duhet të kalojë 5 cm dhe duhet të jetë organike dhe pa ndonjë farë (shih materialet e kapitullit për specifikimet).

4.5 Aplikimi i plehut dhe kimikateve

Lejohen vetëm plehurat dhe kimikatet për trajtimin e lëndinave. Absolutisht nuk lejohet përdorimi i herbicideve ose pesticideve në mirëmbajtjen e gjelbërimit. Nuk ka përjashtime për këtë.

4.5.1 Sistemi i ujitjes

Sistemi i ujitjes është vendimtar për bimët gjatë muajve të nxehtë të verës. Funksionimi i mirë i sistemit duhet të kontrollohet çdo ditë. Kur vërejmë mosfunksionim kjo duhet të riparohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse nuk është e mundur që të riparohet brenda tri ditëve, duhet të aplikohet menjëherë ujitje ditore manuale dhe të vazhdojë deri në riparimin e sistemit të ujitjes.

4.5.2 Rimbjellja

Kur pas punimeve ose në zona ku për shkak të ujitjes ose problemeve të tjera krijohen

hapësira me mangësi në gjelbërim, rimbjellja duhet të ekzekutohet duke pasur parasysh skemën fillestare të mbjelljeve dhe listën e specieve. Duhet të ndiqet okurrenca natyrore dhe bollëku i specieve: speciet që formojnë grup duhet të mbillen në grupe, lloje të tjera më individualisht ose në grupe më të vogla. Grupet ose bimët individuale duhet të shpërndahen me variacion për të shmangur një shpërndarje të barabartë. Cilësia e bimëve duhet të kontrollohet dhe të garantohet.

4.5.3 Punime specifike në gjelbërim

Vendimtare për mirëmbajtjen e gjelbërimit është të kuptuarit se si gjelbërimi kombinohet, funksionon dhe zhvillohet. Punëtorët duhet në çdo kohë të kuptojnë se çfarë po bëjnë. Elementet kyçe janë njohja e teknikave dhe njohja e specieve të ndryshme.

Punimet e ndryshme përshkruhen sipas shtresave të ndryshme ose funksioneve të gjelbërimit: shtresë bimësh shumëvjeçare, shkurre, pemë, pemë frutore, bimë tropikale, hardhi dhe lëndina. Brenda këtyre kategorive bëhen nënkategori të ndryshme sipas trajtimit të ndryshëm që ata kanë nevojë.

4.6 Kategorite e bimeve

4.6.1 Bimë të ulta shumëvjeçare

Shtresa e ulët e gjelbërimit përbëhet kryesisht nga specie të bimëve të ulta shumëvjeçare. Këto specie të ulëta janë të forta, kryesisht lloje jetëgjata që mbulojnë tokën. Kjo shtresë përbëhet nga shumë specie me një shumëllojshmëri të ngjyrës, aromës dhe gjallesave.

4.6.2 Bimë shumëvjeçare të forta

Kjo është kategoria më e rëndësishme e bimëve të ulta shumëvjeçare në aspektin e pasurisë së specieve. Në vjeshtë, shumica e specieve të kësaj kategorie ndryshojnë ngjyrën dhe rrëzojnë gjethet e tyre. Në pranverë vetëm materiali i vdekur, kryesisht gjysëm i kalbur, mbetet mbi tokë; bimët japin filiza të rinj direkt nga sythat në rritje që ndodhen në nivelin e tokës.

Llojet e mëposhtme janë në këtë kategori:
(shih listën)

kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:

- heqja e gjithë materialit bimor të vdekur në fillim të pranverës
- heqja duhet të ekzekutohet përpara se fidanët e rinj të jenë mbi pesë centimetra të larta
- heqja duhet të ekzekutohet pa dëmtuar fidanet e rinj
- të gjitha materialet e ngordhura duhet të hiqen nga vendi
- nuk duhet të merren masa të tjera për këtë kategori

4.6.3 Bimë shumëvjeçare të forta drunore

Kjo kategori përbëhet nga shkurre më të vogla dhe bimë shumëvjeçare drunore. Në dimër ato janë kryesisht gjetherënëse (edhe pse jo të gjitha), por nuk vdesin deri në nivelin e

tokës: çdo vit ato bëhen më të mëdha; baza bëhet shpesh e hollë dhe më pak tërheqëse.

Llojet e mëposhtme janë në këtë kategori:
(shih listën)

kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:

- krasitje e kujdesshme në fillim të pranverës
- krasitja duhet të ekzekutohet në fillim të pranverës ose edhe në pjesën e fundit të dimrit
- krasitja duhet të heqë gjysmën e rritjes së viteve të fundit, mbasi bimët janë përforcuar
- krasitja duhet të bëhet deri në një bulb të shëndetshëm të një fidani më të vogël
- të gjitha materialet e krasitura duhet të hiqen nga vendi
- gjatë krasitjes duhet patur kujdes që të mos thyhen degët e fidaneve të reja, ato shpesh janë shumë delikate

4.6.4 Bimë drunore jetëshkurtra

Kjo kategori përbëhet nga lloje dinamike që janë jetëshkurtra, por që vetëmbijnë lehtë. Ata janë mbushës të natyrshëm të hapësirave boshe: gjatë gjithë viteve ata lëvizin nëpër zonat e gjelbra, duke plotësuar boshllëqet që shfaqen në mbjellje për shkak të farëzimit. Struktura e fortë vertikale e këtyre specieve plotëson pamjen dhe ndjesinë dinamike të vegjetacionit. Shpesh këto specie vdesin pas lulëzimit; por hedhin shumë farëra që sigurojnë mbijetesën e tyre me kalimin e kohës.

Llojet e mëposhtme janë në këtë kategori:
(shih listën)

kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:

- këto bimë nuk duhet të krasiten dhe as nuk kanë nevojë për ndonjë formë të veçantë të kujdesit
- këto bimë duhet të lihen pa prekur pas lulëzimit, kështu që farat të kenë mundësinë të shpërndahen
- kujdes më së shumti duhet të tregohet për të mos hequr filizat e rinj të këtyre specieve gjatë pastrimit të barërave të këqija. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet udhëzimeve të punëtorëve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të njohin këto specie në një fazë të re.

4.6.5 bari perenial dhe jo gjetherënës

Barërat formojnë bazën e "mbjelljeve matricë": ato sigurojnë një masë të gjelbër në të cilën lloje të tjera lulëzojnë dhe shfaqen kur çelin. Përdorimi i barërave jep një ndjenjë shumë natyrale për mbjelljet.

Speciet me gjelbërim jo gjetherënës të kësaj liste janë specie që janë të rëndësishme për aspektin dimëror të vegjetacionit. Këto përfshijnë fiere, specie helleborus dhe euphorbias. (speciet e kësaj kategorie janë specifikuar në listë)

Kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:



Euphorbia chariaca



Helleborus cyclophyllus


- Sesleria nuk ka nevojë të pritët; rrafshimi i bimëve është i mjaftueshëm për të nxjerrë shumicën e gjetjeve të vyshkura; kjo duhet të bëhet një herë në vit në fillim të pranverës, gjatë pastrimit të përgjithshëm
- speciet e ndryshme të helleborus kanë lulëzim dimëror; që nga dhjetori japin lulet dhe krijojnë një freski të mirëpritur dhe befasuese: ky aspekt mund të rritet duke hequr gjethet e vyshkura
- speciet e euforbia nuk duhet të priten fare dhe duhet të mbeten të paprekura

4.6.6 specie potencialisht invazive

Tre llojet duhet të monitorohen gjatë gjithë viteve: melisa officinalis, origanum vulgare dhe speciet vinca. Këto specie janë shumë të vlefshme, por ndryshe nga shumica e llojeve të tjera ato kanë tendencën të përhapen anash nga rrënjët e tyre.
(speciet e kësaj kategorie janë specifikuar në listë)



Melissa officinalis



Origanum vulgare



Vinca major

Kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:

- monitorimi i këtyre specieve për të kontrolluar nëse ato nuk rriten në mënyrë të tepruar
- heqjen e rritjes së tepërt gjatë sezonit të rritjes duke hequr sythat e rinj dhe krasitje.

4.6.7 shkurre

Shkurret formojnë shtresën e mesme të bimësinë së lart; ato janë të rëndësishme për strukturën e përgjithshme të gjelbërimit në aspektin e biodiversitetit, por edhe në aspektin e transparencës: ato krijojnë një perde të gjelbër. Me dendësi të lartë të shkurreve atmosfera e gjelbër është pothuajse e plotë, me dendësi më të ulët lidhja me kontekstin është më e dukshme.

Ne dallojmë dy kategori të ndryshme në shkurret: shkurre me gjelbërim të përhershëm dhe shkurre gjetherënëse. Shkurret me gjelbërim të përhershëm janë më të ngadalta në aspektin e rritjes, që do të thotë se speciet gjetherënëse kanë tendencë për të mbipopulluar dhe shtypur këto specie. Kërkesat e mirëmbajtjes kryesisht kanë për qëllim ruajtjen e ekuilibrit të duhur në densitet dhe ruajtjen e karakterit natyralistik të mbjelljeve.

4.6.8 shkurre gjetherënëse

Shumica me rritje të shpejtë, të gjitha indigjene për Shqipërinë. Të gjitha lulëzojnë dhe sigurojnë fruta për kafshë të egra.

(speciet e kësaj kategorie janë specifikuar në listë)
kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:

- 'krasitje nëpërmjet zëvendësimit': këto specie duhet të krasiten duke hequr disa degë deri në nivelin e tokës. Nuk mund të ketë shkurtim të asnjë lloji!
- krasitja fillon sapo të arrihet lartësia dhe vëllimi i kërkuar



Celtis australis



Cotynus coggygria

- çdo vit 1/3 e shkurreve duhet krasitur
- 1/3 deri 1/2 e degëve të çdo shkurreje hiqet

4.6.9 shkurre jo gjetherënëse

Shumica e shkurreve jo gjetherënëse janë shkurre të ulëta që nuk rriten shumë të lartë. Janë specie shumë persistente dhe të forta, disa prej të cilave përhapen. Këto specie janë shumë të rëndësishme për aspektin dimëror të zonave të gjelbra: ata sigurojnë që edhe në dimër të jetë e garantuar një atmosferë e gjelbër dhe intimitete. (speciet e kësaj kategorie janë specifikuar në listë) kërkesat e mirëmbajtjes së kësaj kategorie:



Laurus nobilis



Rhamnus alaternus

- 'krasitje nëpërmjet zëvendësimit': këto specie duhet të pastrohen duke hequr disa degë deri në nivelin e tokës; nuk mund të ketë asnjë shkurtim të asnjë lloji!
Nderkaq filtrate UV, kanë nevojë për monitorim për të ndërruar llamben UltraViolet, në rast konsumi apo në rast mosfunksionimi sic duhet.

Pompat e vaditjes duhet të jete gjithashtu në monitorim të vazhdueshëm për t'u siguruar që I gjithë gjelberimi sipër sheshit të jete në mbarevajtje të plote dhe të jete aktive dhe pasive sipas nevojave të bimeve në pershtatje me klimën e jashtme.

8.4.3 Kujdesi për dhomen teknike: niveli -2: Dhoma e Sites

Dhoma e Sites është një nga ambientet me të nevojshme për mirembajtje të vazhdueshme pasi është e rëndësishme që çdo ditë dhe shpeshherë disa herë brenda ditës të pastrohet sa herë që mbushet me mbeturina. Ky ambient kërkon një mirembajtje tepër intensive, dhe një punëtor që të jete herë pas here prezent për të hequr manualisht mbeturinat sa herë që grumbullohen apo ngecin në dhomen e sitave.

8.4.4 Kujdesi për dhomen teknike: niveli -2: Depozita e Ujit të Vaditjes

Depozita e ujit të vaditjes ka nevojë për një mirembajtje me të lehtë në krahasim me ambientet e tjera teknike duke qenë se pastrimi I saj bëhet rrallë herë, duke qenë se uji që mbush ete rezervuar është ujë që vjen nga pusi dhe është ujë I paster. Rrjedhimisht kjo kërkon një mirembajtje me të lehtë sesa depozitat e tjera të ujit që kanë nevojë për një pastrim tepër rigoroz dhe sistematik.

8.4.5 Kujdesi për ambientet teknike: niveli -3: Ambientet teknike

Ambientet teknike të katit -3 kanë nevojë për një monitorim të vazhdueshëm të pajisjeve që përmbajnë. Dhe ketu përfshihen të gjitha pompat e filtrave mekanik dhe ato të filtrave UV, si dhe pompat e llumit, si dhe pompat që komandojnë të gjitha shatervanet mbi shesh.

8.4.6 Kujdesi për dhomen teknike: niveli -3: Depozita e Shatervaneve

Depozita e Ujit të Shatervaneve duhet pastruar të pakten 1 herë në muaj. Ajo fillimisht duhet të bëshatset nga uji I shatervaneve. Me pas duhet lare dhe me tej duhet të dizinfektohet. Pas dizinfektimit depozita duhet të shplahet mire disa herë, duke u siguruar mosmbetjen e asnjë solucioni në depozite. Me tej duhet të bëhet mbushja e depozites serish.

09
MIREMBAJTJA E
MOBILIMIT URBAN

9. MOBILIMI URBAN

9.1 Veshtrim i pergjithshëm mbi mobilimin Urban në sheshin Skënderbej

9.2 Stolat (kontrukcionet e betonit)

Planet japin një pasqyrë të të gjitha stolave që duhen vendosur. Sistemi është i përbërë nga 8 elementet themelore:

- Blloku bazik (34x40x49cm)
- Blloku bazik me priza elektrike për përdorim nga publiku dhe për mundësi të ndricimit (nën stol)
- Blloku bazik me ndricim anesor dhe mundësi ndricimi (nën stol)
- Blloku bazik me prize elektrike dhe ndricim (qendron i pavarur)
- Soleta e sipërme është stol i vogël (150x60x15cm)
- Soleta sipërme është stol i harkuar (110/160x60x15)
- Soleta sipërme është stol i gjatë (250x90x15)
- Elementi mbrapa (40x60x10/20)

Vendet e uljes janë blloqe të ndryshme (rrotullimi varion për të siguruar diferencë të ndryshme lartësie), ose stolat janë krijuar nga blloqe dhe nga pjesë të sipërme të soletës. Elementi mbrapa shtohet këtu pas këtu.

Keto vizatime japin një pasqyrë të plote të karakteristikave dimensionale, formës, modulit, dhe treguesve skematik të elementeve të përafërt në ndërtim. Keto vizatime i referohen vizatimeve të zbatimit dhe mundësi për të specifikuar vizatimet e detajuara. Vizatime strukturale për çdo lloj elementi.

9.2.1 Materialet

Të gjithë elementet janë beton i ngjyrosur, me shtim të bazave metalike për prizat elektrike aty ku është e nevojshme. Dizajni i kallepeve të betonit garanton të gjitha kërkesat e tilla si stabiliteti dimensional, kufizimet e tolerancës, ngrutësi, dendësi absolute dhe sipërfaqe cilësore.

9.2.2 Berthama e betonit

Përberja të propozohet nga kontraktori. Materjalet e përdorura duhet të jenë absolutisht të pastra dhe të jenë në përputhje me normat ekzistuese. Raporti i ujit dhe i cimentos duhet të jetë me pak se 0.5. Betoni s'duhet të përmbajë klorure as konsumues të ndryshëm që mund të demtojnë ngjithshmerinë e brendshme të betonit. Një agjent ajër qarkullues mund të përdoret për të reduktuar faktorin E/C dhe për të rritur dendësinë e ujit, megjithatë përdorimi i shtesave në beton mund të aprovohet dhe nga mbikqyresit në vendin e ndërtimit.

Minimumi i presionit të rezistencës së betonit duhet të jetë cilësia B 45 . Cilësia e betonit

do te vleresohet statistikisht. Para heqjes se kallepeve betoni duhet të ketë arritur një rezistencë. te paktën 15N/mm² per te parandaluar krisje ose demtime. Perthithja dhe depertueshmeria e ujit: poroziteti i matur nga zhytja ne uje dhe i thare ne temperature 100 nga 110°C dhe nuk duhet te jete me shume se 6% e peshes se thate. Pas 24 oresh ne uje dhe 2.5 m thelle , Siperfaqja sduhet te kete perthithur me shume se 75 gr/dm². Betoni duhet te jete rezistent ndaj ngrirjeve.

9.2.3 Shtresa dekorative e betonit

Masa e betonit do te jete e ngjyrosur ne tone te ngjyres se kuqe. Nga perzierja e perberesve kemi 50% ngjyre te kuqe te erret dhe 50% ngjyra te ndryshme. Jane te deshirueshme dhe te lejuara ngjyrat e lehta dhe variacionet midis elementeve ne strukture. 10 blloqe bazike do te prodhohen si mostra per te testuar tolerancen ne ngjyre dhe cilesi perpara prodhimit ne seri.



Foto referuese e betonit arkitektonik

Per materjalet e perdorura behet perzgjedhje e kujdeseshme: jane materjale te pastra, te forta dhe kundra ngrirjes. Raporti i ujit dhe i cementos eshte 0.5. Siperfaqja e betonit duhet te jete me densitet te madh per te ndaluar depertimet e ndotesave dhe papastertive . Per kete arsye nuk mund te perdoret asnje lloj agjenti per qarkullimin e ajrit.

Rezistenca, pershkrueshmeria e ujit: shtresa dekorative duhet te plotesoje te njejtat kerkesa si ato te betonit baze.

Rezistenca ndaj ngrirjes: shtresa dekorative duhet te jete e paster dhe kunder ngrirjes. Trashesia e shtrese dekorative duhet te kete dy here te pakten diametrin e kokrres me te madhe qe eshte perdorur, megjithate shtresa sduhet te jete me e holle se 40 mm.

9.2.4 Perforcimet

Çeliku duhet të arrije normat Europiane.

Llogaritjet: llogaritjet e armatures duhet të behen sipas normave ekzistuese dhe do të merren parasysh të gjitha ngarkesat e mundshme dhe koeficientet e përshtatshem të sigurisë. Me konkretisht rastet e mëposhtme në lidhje me ngarkesën që do të merret në konsideratë janë:

- Heqja e kallepeve të elementit kur betoni është akoma shumë i ri.
- Perfundimi, ngarkimi dhe transporti.
- Montimi dhe vendosja.
- Ngarkesat që mbahen nga ana e elementit.

9.2.5 Textura

Elementet e parafabrikuar të betonit duhet të kenë sipërfaqe të lemuar. Sipërfaqja e lemuar vendoset në disa hapa të ndryshëm, gjatë së cilës në mënyrë konstante merr cilësi dhe shkelqim më të madh. Në varësi të hapave të cilat kalon betoni referohet si beton i ilustruar ose i lemuar.

9.2.6 Zbatimi

Plani i vendosjes me tregues skematik të bashkimeve të shtresave dhe tipeve të elementeve. Vizatimet e punës për çdo element. Këto vizatime do të japin një përshkrim të karakteristikave dimensionale, formës, modulit dhe tregues skematik të elementeve konstruktive. Vizatimet i referohen vizatimeve strukturale të zbatimit dhe mundësisë për të patur vizatime të detajuara.

Vizatime strukturale për çdo tip elementi. Për elemente të rinj do të ketë direktiva të reja.

9.2.7 Vendosja

Të gjithë njollat dhe erresimet duhet të shmangen. Nëse bie llaç atëherë ai duhet të pastrohet menjëherë me ujë të pastër.

Të gjitha njollat që mbeten pas vendosjes duhet të hiqen nga kontraktori me një grup të specializuar. Të gjithë elementet duhet të vendosen me kujdes sipas instruksioneve në terren.

9.2.8 Kontrolli

Toleranca e përmasave standarte reale në krahasim me përmasat nominale është rreth 2/1000 me maksimum rreth 5mm dhe me minimum 2mm.

Kontrolli i cilësisë përfshin:

- kontrollin e përmasave / tolerancën / aspektet
- kontrollin e materialit të përdorur
- kontrollin e mjeteve të prodhimit

9.3 Sinjalizimi dhe bordet e informacionit

Sipas specifikimeve përgjithshme të trajtimit të elementeve të celikut zbatohen keto pika:

- Sinjalizimi dhe bordet e informacionit
- Vende për të përdoruesit e ujeve
- Vende për biçiklete
- Koshat e plehrave
- Shtyllë ankori

Sheshi Skënderbej është jo vetëm konceptualisht një ambient i madh shpërndarës këmbësorësh, duke ofruar vende për t'u shpërndarur, për të qëndruar dhe për të kundëruar gjelbërimin, por edhe për grumbullimin e njerëzve.

Mirëmbajtja e mobilimit Urban të sheshit, si një hapësirë jo vetëm për këmbësorët kalimtarë por edhe për pushuesit dhe përdoruesit për më gjatë të kopshteve të ambienteve të sheshit, përbën një nga komponentët më të prekshëm për qytetarët e Tiranës.

Mobilimi Urban në sheshin Skënderbej përfshin të gjitha mobiljet e vendosura në shesh listuar si më poshtë:

- Stolat prej betoni me gurë dekorativ
- Sinjalistika dhe bordet e informacionit
- Shtyllat e fiksuara
- Karriget e levizshme
- Kangjellat e hyrjeve të parkimit
- Barrierat fikse të trafikut
- Barrierat provizore të trafikut
- Mbajëset e biçikletave
- Koshat e plehrave
- Strukturat e përkohshme / pavilione

9.4 Shatervani

- Baza:

Tub i rrumbullakët, 100 mm diametër

Celik i metalizuar dhe i lyster

- Rubineti:

Tub i rrumbullakët, 35 mm diametër, i harkuar

Shty. për ta hapur ose mbyllur

9.5 Vendi i biçikletave

- Baza:

Shufër metalike, 100 mm diametër

I metalizuar dhe i lyster

- Themelet e betonit:

2 blloqe nga 300/300/300 mm

9.6 Koshat e plehrave (60liter)

Koshat e plehrave jane te modeluar sipas koshave ekzistues ne Tirane sipas skemes se meposhtme:

- bare celiku te metalizuar dhe te lyer te cilat mbulojne pllaken e celikut te perforuar. Mundesia per te hapur kapakun per te zbrazur mbeturinat.

(Ref. koshat e zakonshem te plehrave)

- Themelet e betonit:

Te percaktohen nga kontraktori

Te integruara ne cimim


Koshat jane te fiksuar kunder vjedhjes

9.7 Mirembajtja e karrigeve te levizshme

9.7.1 Njohje me karriget e levizshme

Karriget e perkohshme jane ndoshta elementi me I perdorur dhe me I konsumuar nga qytetarët pasi kanë një përdorim direkt nga ata dhe ofrojnë komoditetin të zhvendosen nga njëri vend në tjetrin në mënyrë të vazhdueshme dhe në këto kushte paraqesin mundësi të lartë për t'u dëmtuar, vjedhur, ciflosje të bojës së skeletit, këputje të telave etj.

Karrigia e levizshme eshte projektuar per te ofruar mundesine e zhvendosjes gjate gjithe kohes, duke u vendosur ne nje kontekst si sheshi, I cili nuk eshte I rrethuar gjate nates. Motivi I vendosjes se ketyre karrigeve te levizshme, eshte qe njerezit te kene mundesi ti zhvendosim sipas nevojave dhe dëshirave të tyre. Ato jane ne sherbim te aktiviteteve te ndryshme te grupeve te ndryshme qe e perdorin sheshin. Ky perdorim mund te jete vetjak, ne cift apo ne grupe me te medha, te kombinuara edhe me stolat e tjera fiks



ne ambientet e sheshit, duke krijuar nje lloj pervetesimi te karrigeve te levizshme dhe siguruar nje lloj momenti intimiteti.

Dizenjimi I karriges se levizshme konsiston ne nje format teper te thjeshte, por me dimensione teper specifike: karrigia eshte 80 cm e gjere, duke krijuar kushte 'luksoze' per nje person, ose kushte 'intime' per dy persona ulur ngushtesisht ngjitur me njeri-tjetrin. Dimensioi prej 80 cm nuk rrjedh nga koncepti I 'komfortit', perkundrazi krijon nje lloj barrier, duke provokuar edhe nje zgjedhje: ta ndash karrigen me dike tjeter ose jo, ose te

ulesh afer me dike qe ndihesh rehat mjaftueshem. Po aq e thjeshte, ajo eshte edhe nje mjet e cila ve ne dukje marredhenie te caktuara, I nxjerr ato ne pah ose I stimulon ato. Duke patur nje format kaq fleksibel, mund te shnderrohet ne nje mobilje urbane qe mund te implementohet edhe ne parqe te tjera te qytetit.

9.7.2 Lyerja e karrigeve te levizshme

Në baze të studimit, janë shqyrtuar mbarëvajtja e karrigeve të lëvizshme në harkun kohor të një viti, dhe vihet re se:

Është e nevojshme që lyerja e karrigeve të levizshme të kryhet të paktën 1 herë në total, me bojën origjinale RAL 6021

Ky proces, duhet ti nënshtrohet hapave të përshkruar si më poshtë:

- Heqja e pjesëzave jo metalike

Do të hiqen fillimisht cdo pjesëz e karriges që nuk duhet të lyhet, gomina, tapat fundore etj.

- Larja dhe Pastrimi

Përpara se të kryhet lyerja do të kryhet pastrimi i karriges së lëvizshme. Duhet të lahet skeleti metalik duke përdorur një detergjent të butë dhe të lihet të thahet. Detergjenti duhet të heqë në mënyrë efektive papastërtitë dhe mykun që krijohet në metal. Ajo gjithashtu do të heqë ndryshkun e dukshëm që formohet në sipërfaqen e metalit.

- Krruajtja dhe Fërkimi

Sipërfaqja e strukturës metalike fërkohet me një kruajtës dhe furçë teli metalike për



Karrijet e sheshit

të hequr të gjitha copat e dëmtuara të bojës në sipërfaqe të përthyera ose të rrafshët dhe aty ku ka ndryshk. Nëse boja është fryrë dhe ka krijuar flluska, kjo tregon që ka formacione ndryshku nën të. Këto shtresa mund të fërkohen lehtë me një kruajtëse metalike dhe të fshihen me furcë.

- Heqja e ndryshkut me kimikate
Hiqni ndryshkun e rëndë duke përdorur një produkt për heqjen e ndryshkut. Këto kimikate



Foto e stolit metalik te lyer



Foto e stolit metalik te lyer

anti-ndryshk janë lehtësisht të gjindshme në të gjitha pjeset e materialeve. Këto kimikate janë më efektive për të hequr çdo sasi të madhe ndryshku nga mobilet metalike. Me këto kimikate duhet punuar me kujdes sepse kanë veti gërryese.

- Trajtimi Anti-Ndryshk

Pas heqjes së ndryshkut nga karrigia metalike duhet të aplikohen zgjidhje për mbrojtjen nga gërryerja tek stolat. E gjithë struktura duhet trajtuar me lëndë anti-ndryshk, edhe nëse kjo e fundit kërkon zhytjen e elementëve në lëndën anti-ndryshk.

- Trajtimi me Primer

Duhet të spërkatet një shtresë primer metalik në skeletin e karriges. Spërkatni një shtresë të aluminit metalik në grupe. Është mirë të aplikohet një shtresë primer për mbrojtje më të mirë, veçanërisht nëse metali është tepër i gërryer.

- Rilyerja e karrigeve

Ne etapën e funti, zhvillohet lyerja e karrigeve metalike me bojë zmalto, me një furçë ose llak pas trajtimit anti-ndryshk. Aplikimi i bojës nuk duhet të mbyllet me një shtresë të vetme. Duhet të aplikohen minimalisht dy ose tre shtresa bojë për të mbuluar sipërfaqen plotësisht dhe në mënyrë uniforme. Duhet të lihet çdo shtresë të thatë përpara se të fillohet aplikimi i shtresës së ardhshme të bojës. Lihet boja të thahet krejtësisht për 24 orë. Fërkohet sipërfaqja me lesh celiku dhe dyll shkëlqyes metalik për ta lëmuar.

9.7.3 Zevendesimi I karrigeve te levizshme

Ne raste vjedhjeje apo demtimi madhor te karrigeve te levizshme, atehere keto karrige do te zevendesohen dhe do te riparohen ne rastet qe do te jete e mundur te fiksohet struktura me riparime te vogla.

9.8 Mirembajtja e kangjellave

Mirembajtja e kangjellave ne shesh, te hyrjeve te parkimit, paraqesin nevojte per monitorim te vazhdueshem pasi jane nje element mbrojtës dhe garantor sigurie per te gjithë kalimtarët qe I perdorin keto pasazhe kalimi.

9.8.1 Lyerja e kangjellave

Kangjellat e sheshit mund te ndodhe qe te gervishten dhe me kalimin e kohes fillojne te humbasin ngjyren fillestare. Ne raste te tilla behet lyerja Keto kangjella jane prej celiku dhe jane te lyeja me boje RAL 6021.



kangjellat e hyrjes se parkimit nentokesor nga ana e bulevardit

9.8.2 Zevendesimi I kangjellave



kangjellat tek hyrja kryesor e kembesoreve ne parkimin nentokesor

Kangjellat qe ndodhen ne hyrje te parkimit me kalimin e kohes mund te kerkojne zevendesim per shkak te incidenteve te ndryshme qe mund te ndodhin. Zevenesimi I ketyre pjeseve metalike behet nepermjet heqjes se pjeseve te demtuara dhe zevendesimit te tyre me pjese te reja.

9.9 Lyerje te bllokuesve provizor te trafikut

Nje tjetër element urban I rendesishem per sheshin jane edhe bllokuesit metalik provizor te trafikut te cilet bejne ndarjen e rruges se automjeteve me pjesen e kembesoreve dhe vizituesve te sheshit. Keto elemente ndodhen tere kohes nen efektin e tymit dhe gazrave ndotes qe krijohen nga makinat qe kalojne si dhe nen efektin e pluhurit te rruges. Kjo sjell demtimin e bojës qe I jep ngjyre ketyre bllokuesve provizor. Per te riparuar kete problem do te behet lysterja e ketyre elementeve metalike me boje me kod RAL 6021 cdo 1 vit sipas metodologjise se percaktuar me siper.

9.10 Meremetime te Stolave te Betonit dhe te tavolinave te betonit

Frekuentuesit e sheshit te cilet nuk jane thjesht kalimtar por edhe pushues te ambjenteve qe ofron sheshi , bejne qe stolat e betonit te gjejne nje perdorim te madh prej tyre. Ky perdorim sjell edhe ne demtimin e ketyre stolave I cili shpesh mund te kerkoje zevendesim total te pjeseve te stolave.Ne rast te demtimeve te vogla te ketyre elementeve mund te behet meremetimi me stukim apo derdhje betoni vetem ne vendet e demtuara.

Mund te ndodhe qe keto elemente urban te duhet te riparohen pasi mund te ndodhi demtimi I pjeseve te tyre perberese , sidomos ne pjesen e cepave.

Riparimi I ketyre pjeseve behet nepermjet stukimit me baze cimentoje te bardhe + vinovil + rere te bardhe te imet ,te bluajtur imtesisht dhe ne fund shtohet revinex. Kjo eshte nje perberje e cila zevendeson pjeset e thyera te stolave te betonit.Me pas behet rashinimi me leter zmerile (pas tharjes se ketij produkti).Letra zmerile duhet te jete me dy tre ashpersi.



kangjellat e bllokuesve provizor te trafikut

9.11 Riparime dhe lyerje te koshave te mbeturinave gjashte mujore

Duke patur parasysh qe fluksi I njerzve qe kalojne ne shesh si dhe qe perdorin hapësirat e sheshit ne forma te ndryshme eshte I madh dhe mjaft dinamik do te merren masa edhe per element urban sic jane koshat e mbeturinave.

Koshat e mbeturinave vihen ne perdorim gjate gjithë dites nga qytetaret , nga perdoruesit dhe kalimtarët e sheshit eshte e rëndësishme te parashikohet dhe mirembajtja e ketyre elementeve urban teper te rëndësishem per sheshin. Gjate perdorimit te tyre me kalimin e kohes ndodhin dhe demtime te koshave si dhe boja sa vjen e zbehët ose demtohet ne vende te caktuara. Ne raste te tilla behet riparimi I tyre ose lyerja me boje me kodin RAL te percaktuar 6021 dy here ne vit.

Keto kosha kane nevojë per mirembajtje me ane te kruajtjes dhe lyerjes me boje vaji. Kruajtja behet me leter zmeril.

Per pjeset te cilat jane te ndryshkura fillimisht pasi jane kruajtur lyhen me antiruggio dhe pastaj me boje vaji.



bllokuesit provizor prej betoni te trafikut



pamje nga bllokuesit provizor te trafikut



stol grupi prej betoni te kompozuar



stol individual prej betoni te kompozuar



tavolina e perbashket prej betoni prane Librarise Kombetare

Ne rastin e keputjes te ndonje pjese behet si fillim saldimi dhe me pas ljerja.

Pergola:

Edhe pjesa anash Teatrit te Kukullave e cila eshte ne trajten e nje Pergole kerkon mirembajtje me kalimin e kohes.

Mirembajtja e ketij elementi te rendesishem urban konsiston ne pjesen e bimesise pasi bimet kacavjerrese mund te dalin jashte kontrollit me rritjen e tyre dhe me menyren si shtrihen tek elementi mbajtes.

Per te evituar te tilla probleme duhet bera krasitja dhe drejtimi I filizave ne anen e duhur te struktures mbajtese.

Ne rast rritjeje mund te ndodhi qe kjo strukture mos te mbaje dot te gjithe peshen dhe te keputet atehere pjeset e rrjetezimit mund te zevendesohen ose te shtohen dhe te behet vetem kujdesi per pjesen e bimeve kacavjerrese.

- Paviljonet:

Tribuna



kosh mbeturinash

Tribuna kerkon mirembajtje nepermjet pastrimit te herepashershem te mureve me beton me pigment te zi duke qene se keto element jane te vetmit qe mund te demtohen apo gervishten dhe te kene dalje boje me kalimin e kohes.

Skena

Tek ky paviljon duhet te behet kujdes ne pjesen e dyshemese.Kjo pjese mund te kerkoje riparim per pjesen e rashinimit te betonit.Ne rast carjeje do te behet riparimi me bojak cimentoje dhe me vinovil.

Nje tjeter element I rendesishem I ketij paviljoni eshte edhe perdja qe rrethon kete hapesire.Kjo perde eshte me material rezistent ndaj zjarrit te llojit Serge Ferrari ISO FR ,I ngjyres Black/Copper me nje peshe prej 560 g/m2.

Per pastrimin e kesaj siperfaqjeje behet fshirja me solucionin perkates te kerij materiali, te perzier me uje dhe me pas fshirja me nje cope te thate.



struktura mbajtese e pergolatit



pergola prane sheshit 'Austria'

Dhoma e Ceremonive

Kjo sipërfaqeje mund të demtohet vetëm në rast vandalizimi. Raste të tilla janë shfaqur në pjesët e sipërme të kësaj hapësire, për shkak të rënies së tullave në brezin e fundit.

Në këtë rast kryhet rivendosja e tullave të prishura apo të hequra me njëjten miksturë llaci me pigmentin perkates (i zi dhe kaf).




tribuna në kopshtin e ceremonive

Paviljoni I Bicikletave dhe I Librave

Ne te dyja keto pavijone materialet e perdorura jane te njejta, pra dhe trajtimi I mirembajtjes se tyre do te behet po njesoj.

Ne rast renie pllakash do te behet zevendesimi I pllakes .Hapi I pare eshte prerja e bojakut ne vendet kufitare dhe me pas heqja e kolles se mbetur.Behet vendosja e pllakes se re me kolle dhe ne fund bojaku.

Nje tjeter element qe mund te demtohet ne keto pavijone jane dhe qoshet e kolonave. Demtimi I tyre riparohet me Ardex A-46 I cili eshte nje element qe perbehet nga material ngjites dhe pigment.



skena ne kopshtin e ceremonive

Ne mirembajtjen e ketij pavijoni duhet te merret parasysh dhe demtimi apo bllokimi I tubave te shkarkimit te ujit.Mund te kete demtime ne hidroizolim te cilat duhet riparuar me riberje te pjesshme ose te plote hidroizoluese me biikomponent A+B+Pigment.



dhoma e ceremonive




dhoma e ceremonive



pavilioni i biciletave



pavilioni i librit



pavilioni i librit



pavilioni i librit

10
MIREMBAJTJA GJATE
EVENTEVE

10. MENAXHIMI I EVENTEVE

Studimi projektimi per menaxhimin dhe mirembajtjen e sheshit Skenderbej lidhet ngushte me menaxhimin e hapësirës së tij. Duke njohur kapacitetin e tij zemërgjere për evente dhe për tu transformuar në një hapësirë tepër dinamike studimi kërkon përtej përmasave dhe dimensioneve të sheshit Skenderbej për ta menaxhuar atë sa më mirë, dhe lidhjen e tij me zonën përreth.

Jane studiuar me kujdes skemat e mundshme se si mund të organizohen evente dhe grumbullime të ndryshme në sheshin Skenderbej. Këto evente mund të kenë karaktere të ndryshme, ndaj për këtë arsye studimi ka marrë parasysh të gjitha llojet e eventeve. Jane studiuar me kujdes nevojat për organizime të eventeve që mund të zhvillohen.

Ky hulumtim do të shfrytëzojë eksperiencën e organizimeve të tjera të mëparshme, por do të kërkojë gjithashtu duke u konsultuar me të gjitha institucionet apo aktorët e interesuar për të organizuar evente në shesh, se cila është infrastruktura e perkohshme për të cilën ata kanë nevojë për organizime të ndryshme në shesh. Studimi dhe njohja me këto nevoja është i rëndësishëm për të sygjerruar më tej mënyrën më të mirë për të vendosur këto infrastrukture të nevojshme të perkohshme, duke mbajtur parasysh faktin që asnjë sistem i sheshit Skenderbej të mos cenohet apo të mos demtohet nga elementet e vendosur perkohësisht për mbështetjen e eventeve.

Është me vlerë që ky studim është fokusuar në mënyrën më të mirë për të bërë eficiente



Foto nga organizimi i një eventit të vogël

cdo hapësire të sheshit, si hapësirën e madhe dhe boshe të mesit, por edhe hapësirat e vogla dhe më intime që krijohen ndërmjet objekteve dhe monumenteve të kulturës që rrethojnë sheshin.




Foto nga organizimi i një event

Studimi I mënyrës së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së eventeve kërkon një vëmendje të veçantë për mënyrën e pastrimit të ambienteve në rastet e eventeve, të cilat kërkojnë një perkujdjesje ndryshme nga ai I ritmit të përditshëm. Në raste eventesh, parashikohen lloje të ndryshme mbetjesh në shesh, të cilat nëse nuk pastrohen jo vetëm në mënyrën por edhe në kohën e duhur, mund ta bëjnë më të vështirë pastrimin e mëvonshëm.

Zonat kryesore ku në përgjithësi ka evente i shikojmë dhe në hartën e mëposhtme si SQUARE (Zona qendrore e sheshit ku ka dhe më shumë evente), CEREMONY GARDEN, SUNKEN GARDEN, BOTANICAL GARDEN

- Square (Pjesa e shtruar me gur natyral e Sheshit Skenderbej, ku në përgjithësi zhvillohen dhe eventet më të mëdha, si koncerte, organizime të festive të fundvitit,



Plani i sheshit Skenderbej me zonat përreth të specifikuar

panaire etj

- Ceremomy Garden (Hapesira prane hotel Tirana e cila kohet e fundit perdoret per ceremoni martesore)
- Sunken Garden (Kopeshti I gjelberuar me I madh ne Sheshin Skenderbej. I vetmi aktivitet qe mund te zhvillohet ne kete shesh eshte ndonje piknik I organizuar)

10.1 Pastrimi ne raste eventesh: per evente publike private

Qe nga moment qe sheshi Skenderbej ka perfunduar ndertimin e deri ne ditet e sotme jane numeruar shume evente si publike dhe private.

Eventet publike jane ato avenete qe mbledhin fluks me te medha njerezish, dhe qe ne disa raste kane dhe nevojte me shume struktura per tu vendosur ne shesh, nga ku mund te permendim ketu koncertet e medha qe jane bere ne Sheshin Skenderbej.

Eventet dhe organizimet e ndryshme , sigurisht qe I japin jete sheshit, dhe bejne te mundur pjesemarjen e nje numri me te madh njerezish, por pervec aneve positive kane dhe anet negative.



Ne pjesen e adresimit te efekteve negative , diskutimi është shpesh i kufizuar në problemet praktike (ngjeshja, zhurma, përçarje) dhe pasojat fizike (dëmtimi ndaj strukturave dhe vegjetacionit) të venieve ne pune te ketyre hapësirave si skena, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të dizajnuara si vende eventesh.

Eshte e domosdoshme qe mbas perfundimit te cdo eventit te behet pastrimi sa me I shpejte I te gjithe hapësirës ku eshte bere eventit.

- Pastrimi I dyshemese pas perfundimit te eventit me fshese per heqjen e mbeturinave, ne rastin e nje eventit nje ditore pastrimi behet te nesermen sipas kalendarit normal te pastrimit

- Pastrimi I dyshemese me presion per heqjen e njollave qe mbeten nga eventet, ne rastet kur eventet jane me te zgjatur se 1 dite, si pershembull organizimet per festat e fundvitit, pervec pastrimit ditor normal qe behet ne shesh, ne perfundim te eventit sheshi ka nevojte per pastrim me presion pasi gjithmone keto lloj eventesh lene njolla vaji dhe pijesh.

10.2 Rregullore per perdorimin e eventeve

- Ne raste eventesh ku gjithmone eshte e nevojshme energjia elektrike, anje person I paautorizuar nga firma mirembajtese nuk duhet te hapi panelet apo morsetat e shtyllave per te mare energji elektrike. Mbasi subjektet te jene paisur me leje shfrytezimi te sheshit Skenderbej nga Bahskia Tirane, do paraqiten prane subjektit qe ben mirembajtjen e sheshit, dhe do jete elektrikisti I cili do jete present me 2 turne ne shesh, per te bere lidhjet e nevojshme elektrike. Vetem elektrikisti I din pikat me te aferta, apo panelin me te afert nga ku mund te meret energji elektrike
- Mjetet e transportit qe do te kene akses ne shesh per arsye ngarkimi apo shkarkimi nuk duhet ne asnje menyre te shkelin ne zonat e gjeleberuara
- Nuk lejohet te behen vrime ne dyshemete me gur natyral, ne dyshemete me asfalt, dhe ne dyshemete me beton te lare dhe te rrashinuar. Te vetmet siperfaqe dyshemeje ne te cilat mund te behen vrime jane siperfaqet me gur granil.
- Siperfaqet metalike ne asnje menyre nuk duhet te mbeshteten direkt ne siperfaqen e gurit natyral, metalet lene shenja ndryshku ne gur natyral dhe do te ishte I nevojshem nje pastrimi me nje solucion te vecante qe me shume veshtiresi heq ndryshkun
- Asnje mjet transporti, per asnje arsye nuk lejohet te kaloje apo te shkele mbi shatervane.
- Ne siperfaqen e sheshit mbi parkimin nentokesore nuk lejohet te kalojne makina me te renada se 8 ton per aks



Foto nga shkarkimi para eventeve ne shesh



Foto nga shkarkimi para eventeve ne shesh



Foto nga montimi i strukturave ne shesh




Foto nga montimi i strukturave ne shesh




Foto nga montimi i strukturave ne shesh




Foto nga montimi i strukturave ne shesh

- Ne sipërfaqen e sheshit, përveç pjesës mbi parkimin nëntokësor, nuk lejohen makina me të rënda se 10 ton për aks
- Skelat asnjehere nuk duhet të mbështeten mbi dyshemene me gur natyral pa vene tako druri me pare

10.3 Detyrimet e demtuesit

- Pastrimi me presion që I bëhet të gjithë sheshit mbas përfundimit të një eventit me shumë se 1 ditë është detyrim i organizatorit të eventit
- Pastrimi me solucion për ndryshkunj, nëse nuk është zbatuar rregullorja e mesipërme, është detyrim i organizatorit fatura e solucionit dhe pastrimit
- Në rast se organizatori në kundërshtim me rregulloren, hap vrima në dysheme të gurit natyral apo dysheme të tjera, është i detyruar të bëjë pagesën për zëvendësimin e çdo sipërfaqe të demtuar
- Në rastet e një eventit një ditë pastrimi që bëhet të nesërmen nuk është detyrim i organizatorit të eventit
- Në rast se një mjet transporti që bën ngarkime dhe shkarkime, shkel në një sipërfaqe të gjelberuar dhe prish bimët, është detyrë e organizatorit të paguaj zëvendësimin e bimës së demtuar.
- Në rastin e demtimit të gurit natyral të shtruar në qendër të sheshit, është detyrim i organizatorit të zëvendësojë gurin e thyer
- Në rastet kur gjatë një eventit demtohen panelet elektrike sepse dikush I paautorizuar ka ndërhyrë, është detyrim i organizatorit riparimi i panelit
- Për të bërë një përmbledhje të detyrimeve të demtuesit, nëse gjatë një eventit ka demtime të çdo lloji kategorie të cilat vijnë prej fajit të organizatorit, atëherë çdo demtim duhet të demshperblehet nga organizatori

10.4 Kalendarit i eventeve dhe njoftimi paraprak

Në rastin kur një subjekt do të organizojë një event në Sheshin Skënderbeje, si fillim duhet të marrë lejen pranë Bashkisë Tiranë, dhe të bëjë pjesë e kalendarit vjetor të Drejtorisë së eventeve pranë Bashkisë Tiranë. Subjekti i cili do të bëjë mirëmbajtjen e sheshit do të pajiset me kalendarin e eventeve në fillim të çdo viti, dhe staf i këtij subjekti do të jetojë në çdo rast eventit për të asistuar që më së miri këto demtime.

11

KONTROLI I TRANSPORTIT
DHE QARKULLIMIT

Studimi projektimi per menaxhimin dhe mirembajtjen e sheshit Skenderbej lidhet ngushte me menaxhimin e hapesires se tij. Duke njohur kapacitetin e tij zemergjere per evente dhe per tu transformuar ne nje hapesire teper dinamike studimi kerkon pertej permasave dhe dimensioneve te sheshit Skenderbej per ta menaxhuar ate sa me mire, dhe lidhjen e tij me zonen perreth.

Do studiohet me hollesi kalendari i aktiviteteve qe do te zhvillohen gjate gjithë vitit, per te ndertuar edhe nje kalendar te kontrollit te trafikut.

Eshte studiuar me kujdes menyra e aksesimit ne sheshin Skenderbej, se si do te kryhet aksesimi i makinave per ne objektet ku duhet te parkojne dhe se cilat hapesira jane te hapura per qarkullimin e makinave. Studimi mban parasysh faktin qe prioritet ne kete shesh jane kembesoret dhe makinat jane ne plan te dyte, ndaj eshte i rendesishem te kordinohen keto objekte nga makinat duke mos cenuar karakterin pedonal te sheshit. Nderkaq eshte studiuar menyra me e mire per te kontrolluar orientimin e makinave duke mos lejuar krijimin e nje kaosi ne zonen qendrore te qytetit.

Ne rastet e vecanta te delegacioneve apo te eventeve te rendesishme qe ndodhen ne objekte, do te kordinohen sistemi i trafikut ne shesh, me orientimin e makinave drejt e ne parkingjet e objekteve respektive.



Pistonat qe bllokohen hyrjen e automjeteve ne shesh

Ky studim-projektim per kapitullin e transportit dhe qarkullimit shtrihet jo vetem brenda perimetrit te sheshit Skenderbej, por edhe jashte tij duke pare me gjere deri ne Unazen e vogel, pasi ky eshte brezi i transportit nga i cili ky shesh do te ushqehet dhe do te furnizohet. Ndaj, studimi do te shqyrtoje nga afer pikat e aksesit te makinave nga unaza e vogel, per te evituar konflikte apo makinat e paautorizuara te futen ne sheshin Skenderbej.

Ashtu sikur duket dhe ne planin e pergjithshem te organizimit te trafikut, sheshi Skenderbej ndahet ne 4 zona te ndryshme

- Zona kembesore – nje zone eskuzivisht per kembesoret, kryesisht jane pjeset e parqeve perreth sheshit
- Zona kembesore por me akses te kufizuar bicikletash me nje destinacion te percaktuar
- Zona kembesore me leje te kufizuar te automjeteve per VIP dhe sherbime
- Zona kembesore me levizje te kufizuar automjetesh me nje destinacion te percaktuar

11.1 Percaktimi I automjeteve dhe mjeteve qe lejohen ne ambjentet e sheshit

Duke qene se sheshi perfshin objekte me nje rendesi te vecante kulturore, dhe karakter te ndryshem nga objektete me te shumta te qytetit eshte e rendesishme, qe sherbimet ne keto objekte te arrijne ne menyre te lehte dhe te kene mundesine te shkarkojne e ndalojne duke mos u konfliktuar me karakterin pedonal te sheshit.

Ndertesat te cilat rrethojne sheshin Skenderbej, jane te gjitha ndertesa te nje rendesie te vecante, si muzeu kombetar, teatri I operas dhe baletit, banka e Shqiperise, xhamia e Ethem Beut, Bashkia Tirane. Te gjitha ndertesat e lartpermendura jane institucione te cilat per arsyet te ndryshme kane nevoje per akses automobilistik.

- Ne nje orar te caktuar, I cili do pasqyrohet ne kalendarin e trafikut do te lejohen te gjitha automjetet te cilet jane brenda tonazhit te percaktuar ne rregullore dhe jane te paisura me leje te posateshme, per te bere shkarkimet/furnizimet ne lidhje me institucionet e lartpermendura.

Sic eshte permendur ne kapitujt e kaluar ne Sheshin Skenderbej tashme ka nje kalendar te paracaktuar eventesh. Per te gjitha eventet qe zhvillohen ne shesh eshte I nevojshem akses i makinave per shkarkimin e materialeve te ndrsyhme

- Ne nje orar te caktuar, kur fluksi I njerezve eshte me I ulet do te lejohet akses i sheshit I automjeteve qe kane furnizimet per permbushjen e eventeve te ndrsyhme.

11.2 Aksesit I pajisjeve dhe makinerive

Pas nje studimi te mirefillte, u vendos qe hyrja e automjeteve per ne Sheshin Skenderbej te behet vetem nga ana e Bulevardit Zogu i Pare. Nga aty mund te behet shprendarja ne destinacionet e tjera te sheshit. Ne perditshmeri rruga eshte e pakalueshme per shkak te pistonave, komandimin e te cileve e ka ne dore Bashkia Tirane dhe subjekti qe ben mirembajtjen e sheshit

Per automjetet qe jane te lejuara te kene akses ne shesh kemi folur dhe ne kapitullin e menaxhimit te eventeve, pasi persha e automjeteve eshte pjese rregullores per menaxhimin e eventeve.

- Asnje mjet transporti, per asnje arsye nuk lejohet te kaloje apo te shkele mbi shatervane.
- Ne siperfaqen e sheshit mbi parkimin nentokesore nuk lejohet te kalojne makina me te renada se 8 ton per aks
- Ne siperfaqen e sheshit, pervec pjeses mbi parkimin nentokesor, nuk lejohen makina me te renda se 10 ton per aks

iRI